



STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE

TEZA: “Reformat e sistemit arsimor në Maqedoni dhe Shqipëri, analizë komparative për periudhën kohore 2008-2016”

Kandidati:

Hilmi Gashi 127474

Mentori:

Prof. Dr. Jonuz ABDULLAI

Tetovë, 2019

PËRMBAJTJA

HYRJE

- I. ANALIZA E POLITIKËS ARSIMORE NË MAQEDONI
 - Vështrim i përgjithshëm teorik mbi arsimin dhe shoqërinë bashkëkohore në Maqedoni
 - Arsimi në Maqedoni pas pavarësisë
 - Reformat në arsim dhe sfidat në Maqedoni
 - Analizë e strategjisë arsimore të Maqedonisë 2018-2025
- II. ANALIZA E POLITIKËS ARSIMORE NË SHQIPËRI
 - Vështrim i përgjithshëm teorik mbi arsimin në Shqipëri
 - Arsimi në Shqipëri pas rënies së komunizmit
 - Reformat në arsim në Shqipëri
 - Analizë e strategjisë arsimore të Republikës së Shqipërisë 2014-2020
- III. ASPEKTI KOMPARATIV I POLITIKAVE ARSIMORE NË MAQEDONI DHE NË SHQIPËRI
 - Raportet vlerësuese për arsimin në Maqedoni
 - Raportet vlerësuese për arsimin në Shqipëri
 - Analiza komparative e politikave arsimore
- IV. SHPALOSJA E REZULTATEVE NGA HULUMTIMI
 - Metodologjia hulumtuese
 - Rezultatet nga hulumtimi i realizuar
- V. KONSTATIME DHE REKOMANDIME

BIBLIOGRAFIA

LISTA E SHKURTESAVE

MASH – Ministria e Arsimit dhe Shkencës

BE – Bashkimi Evropian

PSA – Plan i strategjik i arsimit

KKM – Korniza e kurrikulës së Maqedonisë

KP – Këshilli i prindërve

KMSH – Këshilli mësimor – shkencor

SNKA - Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit (UNESCO-ISCED)

UNESCO - Organizata e Kombeve të Bashkuara për edukim, shkencë dhe kulturë

UNDP - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

USAID – Agjencia e SHBA-ve për zhvillim ndërkombëtar

BB – Banka Botërore

KNK – Korniza Nacionale e Kualifikimeve

KEK – Korniza Evropiane e Kualifikimeve

ESHS - Enti Shtetëror i Statistikës

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Statistika përshkruese e të dhënave

Tabela 2. Kënaqësia nga reformat e realizuara në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit

Tabela 3. Realizimi i reformave në mënyrën e duhur

Tabela 4. Kënaqësia nga reformat sipas modelit të Kembrixhit

Tabela 5. Modeli i Kembrixhit a ofron arsim kualitativ

Tabela 6. Çka ju pëlqen më së shumti në arsimin sipas modelit të Kembrixhit

Tabela 7. A mendoni se zbatimi gradual i reformave do të jep një arsim më kualitativ

Tabela 8. Sa mendoni se ndikon rroga e mësimdhënësit dhe kushtet e punës në kualitetin e arsimit në përgjithësi

Tabela 9. A mendoni se mësimdhënësit trajtohen në mënyrë të duhur në shoqëri

Tabela 10. A mendoni se përzgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet në mënyrë të duhur

Tabela 11. Sa mendoni se është implementuar strategjia e arsimit nga ana e qeverisë

Tabela 12. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë

Tabela 13. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Kënaqësia nga reformat e realizuara në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit

Tabela 14. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Realizimi i reformave në mënyrën e duhur

Tabela 15. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Kënaqësia nga reformat sipas modelit të Kembrixhit

Tabela 16. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Modeli i Kembrixhit a ofron arsim kualitativ

Tabela 17. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Çka ju pëlqen më së shumti në arsimin sipas modelit të Kembrixhit

Tabela 18. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * A mendoni se zbatimi gradual i reformave do të jep një arsim më kualitativ

Tabela 19. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Sa mendoni se ndikon rroga e mësimdhënësit dhe kushtet e punës në kualitetin e arsimit në përgjithësi

Tabela 20. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * A mendoni se mësimdhënësit trajtohen në mënyrë të duhur në shoqëri

Tabela 21. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * A mendoni se përzgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet në mënyrë të duhur

Tabela 22. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Sa mendoni se është implementuar strategjia e arsimit nga ana e qeverisë

LISTA E GRAFIKONEVE

Figura 1. Kënaqësia nga reformat e realizuara në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit

Figura 2. Realizimi i reformave në mënyrën e duhur

Figura 3. Kënaqësia nga reformat sipas modelit të Kembrixhit

Figura 4. Modeli i Kembrixhit a ofron arsim kualitativ

Figura 5. Çka ju pëlqen më së shumti në arsimin sipas modelit të Kembrixhit

Figura 6. A mendoni se zbatimi gradual i reformave do të jep një arsim më kualitativ

Figura 7. Sa mendoni se ndikon rroga e mësimdhënësit dhe kushtet e punës në kualitetin e arsimit në përgjithësi

Figura 8. A mendoni se mësimdhënësit trajtohen në mënyrë të duhur në shoqëri

Figura 9. A mendoni se përzgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet në mënyrë të duhur

Figura 10. Sa mendoni se është implementuar strategjia e arsimit nga ana e qeverisë

Figura 11. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë

Figura 12. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Kënaqësia nga reformat e realizuara në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit

Figura 13..Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Realizimi i reformave në mënyrën e duhur

Figura 14. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Kënaqësia nga reformat sipas modelit të Kembrixhit

Figura 15. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Modeli i Kembrixhit a ofron arsim kualitativ

Figura 16. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Çka ju pëlqen më së shumti në arsimin sipas modelit të Kembrixhit

Figura 17. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * A mendoni se zbatimi gradual i reformave do të jep një arsim më kualitativ

Figura 18. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Sa mendoni se ndikon rroga e mësimdhënësit dhe kushtet e punës në kualitetin e arsimit në përgjithësi

Figura 19. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * A mendoni se mësimdhënësit trajtohen në mënyrë të duhur në shoqëri

Figura 20. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * A mendoni se përzgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet në mënyrë të duhur

Figura 21.. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Sa mendoni se është implementuar strategjia e arsimit nga ana e qeverisë

Abstrakti

Të gjitha shoqëritë më bashkëkohore arritjet e tyre i kanë realizuar përmes arsimit. Arsimi është fuqia e cila lëviz të gjitha nivelet e një shoqërie në mbarë botën. Nuk mundet të paramendohet zhvillimi kulturor, teknologjik, ekonomik pa një arsim cilësor dhe adekuat i cili do të depërtojë tek të gjitha shtresat shoqërore.

Sistemin arsimor i Maqedonisë has në shumë pengesa, siç janë problemet me tekstet shkollore, objektet e vjetruara, pajisje të pamjaftueshme dhe mungesë të kuadrove profesionale. Nga ana tjetër, arsimi në Shqipëri kalon përmes një transformimi i cili në shikim të parë duket se ka një ecuri normale, por edhe atje vërehen sfida dhe pengesa të ndryshme në gjetjen e cilësisë dhe përafrimin me standardet e shteteve bashkëkohore.

Në mënyrë që të arrijmë deri tek rezultatet dhe informatat e duhura në këtë hulumtim shkencor, do të përdorim disa nga llojet e metodologjisë hulumtuese, edhe atë duke nisur me analizën e teksteve dhe dokumenteve zyrtare të institucioneve relevante në Maqedoni dhe Shqipëri, analizën e teksteve shkollore dhe literaturës vendore dhe asaj ndërkombëtare, duke bërë një analizë krahasuese në mes të dy shteteve dhe duke përfunduar me pyetësorin i cili është plotësuar nga punonjësit e arsimit dhe palët e prekura nga arsimi siç janë nxënësit dhe prindërit.

ABSTRACT

Nowadays, all contemporary societies have achieved their developments through education. Education is the power that moves all levels of a society around the world. Cultural, technological, economic development cannot be imagined without a qualitative and adequate education that will penetrate and move all social strata.

Macedonia's education system has many obstacles, such as problems with textbooks, outdated facilities, inadequate equipment and lack of professional staff. On the other hand, education in Albania passes through a transformation that seems to have a normal performance at first glance, but there are also challenges and obstacles in finding quality and aligning with the standards of contemporary states.

In order to reach the results and the relevant information in this scientific research, we will use some of the types of research methodology, starting with the analysis of texts and official documents of the relevant institutions in Macedonia and Albania, the analysis of textbooks and domestic and international literature, making a comparative analysis between the two countries and ending with a questionnaire filled in by education employees and affected education stakeholders such as students and parents.

HYRJE

Të gjitha shoqëritë më bashkëkohore arritjet e tyre i kanë realizuar përmes arsimit. Arsimi është fuqia e cila lëviz të gjitha nivelet e një shoqërie në mbarë botën. Nuk mundet të paramendohet zhvillimi kulturor, teknologjik, ekonomik pa një arsim cilësor dhe adekuat i cili do të depërtojë tek të gjitha shtresat shoqërore.

Sistemin arsimor i Maqedonisë has në shumë pengesa, siç janë problemet me tekstet shkollore, objektet e vjetruara, pajisje të pamjaftueshme dhe mungesë të kuadrove profesionale. Nga ana tjetër, arsimi në Shqipëri kalon përmes një transformimi i cili në shikim të parë duket se ka një ecuri normale, por edhe atje vërehen sfida dhe pengesa të ndryshme në gjetjen e cilësisë dhe përafrimin me standardet e shteteve bashkëkohore.

Në mënyrë që të arrijmë deri tek rezultatet dhe informatat e duhura në këtë hulumtim shkencor, do të përdorim disa nga llojet e metodologjisë hulumtuese, edhe atë duke nisur me analizën e teksteve dhe dokumenteve zyrtare të institucioneve relevante në Maqedoni dhe Shqipëri, analizën historike dhe ajo e përmbajtjes gjatë hulumtimit për analizimin e të dhënave të grumbulluara, shqyrtimin dhe përpunimin e tyre, analizën e teksteve shkollore dhe literaturës vendore dhe asaj ndërkombëtare, duke bërë një analizë krahasuese në mes të dy shteteve dhe duke përfunduar me pyetësin e cili është plotësuar nga punonjësit e arsimit dhe palët e prekura nga arsimi siç janë nxënësit dhe prindërit.

Për këtë arsye, qëllimi i këtij punimi është që nëpërmjet analizës dhe krahasimit të strategjive dhe reformave arsimore në të dyja shtetet e Ballkanit Perëndimor të arrijmë deri tek rezultatet të cilat do të na mundësojnë një pasqyrë më të përafërt për trendet pozitive dhe negative të këtyre zhvillimeve gjatë periudhës kohore e cila do të mbulohet në këtë punim hulumtues shkencor. Si rrjedhojë do të japim edhe hipotezat e këtij hulumtimi të cilat do të na ndihmojnë që ky punim të marrë edhe trajtën shkencore dhe të përbëjë një dokument serioz i cili do të shërbejë për përmirësimin dhe reformimin e duhur të arsimit në Maqedoni.

Hipoteza kryesore mbështetet në tezën se ***reformat në arsim në dekadën e fundit nuk japin rezultatet e duhura në aspektin e cilësisë***, ndërsa si hipotezë ndihmese do të vërtetojë se ***roli i***

mësuesit është bërë pre e politikës ditore për përfitime elektorale, gjë e cila ndikon në cilësinë e shërbimit të ofruar.

Faza e parë e hulumtimit bazohet në grumbullimin e të dhënave nga Strategjitë arsimore në vendet e cekura në hulumtim si dhe nga burime tjera me relevancë si të dhënat e publikuara nga institucionet shtetërore dhe organizata te ndryshme joqeveritare.

Metodologjia e aplikuar për këtë punim do të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të gjendjes së arsimit në Republikën e Maqedonisë dhe të Shqipërisë si dhe nivelin e implementimit të rekomandimeve dhe reformat e realizuara në arsim.

Ky hulumtim shkencor përbëhet nga pesë kapitujve. Në ***kapitullin e parë*** jepet analiza e politikës arsimore në Maqedoni, duke bërë një vështrim të përgjithshëm teorik mbi arsimin dhe shoqërinë bashkëkohore, duke shfaqur të dhëna mbi arsimin në Maqedoni pas pavarësisë, reformat në arsim, sfidat dhe duke bërë në fund një analizë mbi strategjinë arsimore të Maqedonisë 2018-2025.

Në ***kapitullin e dytë*** do të japim të dhëna mbi analizën e politikës arsimore në Shqipëri, duke bërë një vështrim të përgjithshëm teorik mbi arsimin atje, kontekstin historik, reformat në arsim në Shqipëri, dhe gjithashtu duke përfunduar me analizën e strategjisë arsimore të republikës së Shqipërisë 2014-2020.

Në ***kapitullin e tretë*** kemi aspektin komparativ të politikave arsimore në Maqedoni dhe në Shqipëri, duku shfaqur të dhëna mbi raportet vlerësuese për arsimin në Maqedoni dhe në Shqipëri, si dhe duke përfunduar me analizë të politikave arsimore.

Në ***kapitullin e katërt*** kemi shpalosjen e rezultateve nga hulumtimi i realizuar përmes pyetësorit, paraprakisht duke sqaruar metodologjinë hulumtuese të aplikuar dhe duke bërë paraqitjen tabelare të rezultateve nga hulumtimi i realizuar.

Në ***kapitullin e fundit*** do të japim konstatimet të cilat do të bazohen në rezultatet nga hulumtimi i realizuar dhe analiza e materialeve paraprake. Përmes këtij punimi synojmë që këto dilema dhe vështirësi ti zbërthejmë në atë masë që do të na mundësojë të japim kontributin tonë përmes rekomandimeve të cilat do të burojnë nga ky hulumtim.

KAPITULLI I

ANALIZA E POLITIKËS ARSIMORE NË MAQEDONI

Vështrim i përgjithshëm teorik mbi arsimin dhe shoqërinë bashkëkohore në Maqedoni

Maqedonia në dekadën e fundit është karakterizuar me jo-stabilitet politik, ekonomi të pazhvilluar, normë të lartë të papunësisë, dhe së fundi ikja masive e trurit nga vendi. Sipas të dhënave nga raporti i fundit i strategjisë për arsim i siguruar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në periudhën 2009-2015, migrimi neto u rrit vazhdimisht nga 1,065 në 4,342 – kryesisht nga shkaku i numrit të të huajve me qëndrim të përkohshëm – mirëpo në vitin 2016 u regjistrua rënie prej 4,113. Njëherazi edhe migrimi neto i banorëve në Maqedoni ka një përmirësim të vogël, po përsëri mbetet negativ (nga -510 më 2009 deri -157 më 2016).¹

Në vitin 2013 për studentet e Maqedonisë pesë shtete më të popullarizuara kanë qenë: Bullgaria (1197), Italia (507), Gjermania (425), Austria (412) dhe Turqia (361), ndërsa studentet e huaj që kane studiuar në universitetet e vendit tone kane qenë kryesisht nga: Serbia (1146), Shqipëria (230), Turqia (211), Bullgaria (30) dhe Kroacia (24).²

Sistemi arsimor në Republikën e Maqedonisë përbëhet nga arsimi parashkollor, fillor (6-14 vjeç), i mesëm (15-17/18 vjeç) dhe i lartë. Arsimi fillor zgjat nëntë vjet, është i detyrueshëm dhe pa pagesë për të gjithë nxënësit (e moshës 6-14 vjeçe). Arsimi i mesëm, që po kështu është i detyrueshëm dhe pa pagesë, është i ndarë në katër lloje: gjimnaz, arsim i mesëm profesional, arsim artistik dhe arsim për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore. Arsimi i mesëm profesional mund të zgjasë 3-4 vite. Pasi t'i kryejnë tre vjet arsim profesional, nxënësit hyjnë në provimin përfundimtar dhe nuk kanë të drejtë të regjistrohen në universitet. Nxënësit që kryejnë arsimin e mesëm profesional katërvjeçar mund të zgjedhin ose provimin përfundimtar ose maturën shtetërore, varësisht nga dëshira për të vazhduar shkollimin ose jo, kurse nxënësit e gjimnazeve në mënyrë të detyrueshme i nënshtrohen maturës shtetërore ose shkollore. Arsimi i

¹ Enti Shtetëror i Statistikes, Migrimet 2016. http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija_en.aspx?id=9

² UNICEF, Migration Profiles: The Former Yugoslav Republic of Macedonia

lartë realizohet në tri nivele: universitar, i magjistraturës dhe i doktoratës. Në vendin tonë funksionojnë gjashtë universitete shtetërore (dy prej tyre në gjuhën shqipe), 1 universitet privat-publik dhe 9 universitete private dhe dy shkolla të larta profesionale.³

Në arsimin fillor mësimi organizohet në katër gjuhë mësimore (maqedonisht, shqip, turqisht dhe serbisht), ndërkaq në shkollimin e mesëm në tri gjuhë mësimore (maqedonisht, shqip dhe turqisht). Pothuaj 29% e shkollave fillore dhe 34% e shkollave të mesme janë dygjuhëshe / tregjuhëshe.⁴

Në kuadër të kontekstit politik dhe ekonomik në të cilin gjendet Maqedonia, duhet potencuar se kriza ekonomiko financiare botërore më tepër u reflektua në shtet në zhvillim, sepse ato janë të varura nga mbështetja, përkrahja dhe investimet e huaja, gjë që mund të vërehet edhe në këtë moment në shtetet e Ballkanit perëndimor. Këto shtete ballafaqohen me probleme të mëdha ekonomike, por njëkohësisht janë të ballafaquara edhe me një krizë politike e cila nuk mundet të zgjidhet me zgjedhje të njëpasnjëshme të parakohshme parlamentare, si që është rasti në Kroaci, Serbi, Maqedoni dhe Greqi. Fillimi i zgjedhjes së krizës politike në këto shtete do të thotë edhe fillimi i mirëfilltë i procesit të demokratizimit të qeverisjes së shtetit. Procesi i demokratizimit dhe reformimi i sistemeve autoritare sipas Samuell Hantingtonit, do të mundet të realizohet nëse merret mësim nga reformatorët demokratik gjatë vitit 1990, nga transformimet në Spanjë dhe Brazil. Marrëveshja politike në mes opozitës së moderuar dhe pozitës arbitrare erdhi si rezultat i marrëdhënieve të ndërlikuara në mes tyre, por faktor stabilizues në këtë proces ka qenë konsensusi ekzistues në mes ushtrisë dhe civilëve për rikthimin e një sistemi politik të hapur. Në veprën e tij “Vala e tretë”, S. Hantingtoni jep udhëzime për demokratizim të shteteve të cilat ende nuk kanë bërë transformimin e vërtet ose të vet shpallurit “demokratë”, janë shndërruar në regjime autoritare, prandaj edhe propozohen këto ndryshime: reformimi i sistemeve autoritare, përmbysja e regjimeve autoritare dhe bisedime për ndryshimin e regjimit. Këto udhëzime Hantingtoni i propozon duke bërë një elaborim të gjerë dhe të kompletuar, në mënyrë të detajuar analizon procesin e sundimit autoritar në shumë shtete, duke filluar nga Peru, Ekuador, Guatemalë, Bullgari, dhe duke përfunduar me rastet në Spanjë dhe Brazil. “Atje ku udhëheqësit autoritar nuk vdiqën dhe nuk ndërroheshin rregullisht, reformatorët demokratë duhet

³ Strategjia e Arsimit në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2018-2015, f.14

⁴ Burimi: Projekti i USAID-it për integrimin ndëretnik në arsim.

ta rrëzonin sunduesin dhe të vendosnin një udhëheqje pro-demokratike. Kjo që ceket më latë është praktika dhe realiteti i viteve të nëntëdhjeta nga shekulli i kaluar, kurse ajo që duhet bërë tani është ndryshimi urgjent i udhëheqësive autoritare dhe ardhja e përfaqësuesve të vërtet të popullit. Ndryshimet duhet të bëhen urgjentisht, sepse demokratizimi i vendit në këto shtete është parakusht për çdo ndryshim shoqëror, si që është ndryshimi i mënyrës së votimit, mos ju besohet atyre që e kanë zhgënjyer popullatën e vetë dhe e kanë sjell në një gjendje të mjerueshme. Ndryshimet duhet të sjellin një garniturë të re qeveritare, por në të njëjtën kohë përshëndetje me “kuazi demokratët” që kanë përcjellë gjatë tërë kohës popullatën në periudhën e tranzicionit të stërzgatur. Procesi i demokratizimit të shteteve në tranzicion vazhdon të jetë preokupim i analizave politike dhe vazhdon të preokupoj qarqet shkencore duke hulumtuar shkaqet dhe pasojat nga e kaluara e afërt, por është edhe një shpresë për gjeneratat e reja që ballafaqohen me sfidat aktuale.⁵

⁵ Jonuz Abdullahi, Politika dhe politikat publike, Arberia Design, Tetovë

Arsimi në Maqedoni pas pavarësisë

Arsimi në Maqedoni është duke u përballur me sfida të mëdha të cilat në përgjithësi dalin nga nevoja për reforma në këtë sektor shumë të rëndësishëm shtetëror, nga zbatimi i tyre dhe implikimet e mëvonshme, dështimin e objektivave të përshkruara në strategjitë për zhvillimin e arsimit, dhe trendi i zvogëlimit të numrit të nxënësve, gjë e cila po rritet çdo vit si rezultat i emigrimit të të rinjve nga shteti.

Duke folur për reformat në arsim dhe zbatimin e tyre, situata aktuale në këtë sektor thekson se institucionet shtetërore nuk arritën të marrin parasysh të gjitha pasojat e aplikimit të njëjtë, duke treguar kapacitet të pamjaftueshëm të planifikimit, organizimit dhe zbatimit. Kjo mund të konstatohet nga të dhënat e publikuara nga raporti i auditimit të titulluar "Efektiviteti i programeve dhe masave që synojnë zhvillimin e arsimit të mesëm", zbatuar nga Auditori i Shtetit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, ku në vijim do të prezantojmë disa nga gjetjet e realizuara nga ky institucion:

- Mungesa e analizës së rezultateve të testimit të jashtëm, problemet financiare me të cilat përballen shkollat e që kanë të bëjnë me transportin falas të nxënësve si dhe investimeve të zgjeruara të infrastrukturës në arsim. Në vitin 2015, shkollat kishin detyrime në shumë prej 4.9 milion euro vetëm për transportin e nxënësve.
- Nga gjithsej 583 kërkesave për lëshimin e teksteve shkollore për arsimin e mesëm në shkollat profesionale, janë miratuar 324 vetëm tekste shkollore.

Në vijim do të prezantojmë edhe rekomandimet e Auditorit Shtetëror:

- Zbatimi i plotë i projektit të librave, përcaktimi i nevojës për tekstet shkollore dhe furnizimi i shkollave me numrin e nevojshëm të tyre si dhe respektimi i projektit për transport falas.
- Monitorim të zhvillimit profesional të mësuesve, si dhe krijimi i një sistemi për trajnime.
- Forcimi i përfshirjes së kompanive dhe bizneseve në krijimin e kurrikulave në kuadër të forcimit të lidhjes ndërmjet shkollave profesionale dhe tregut të punës.
- Reformat profesionale të arsimit të mesëm profesional të bëhen sipas nevojave të deklaruara të tregut të punës.

Në një analizë politike në Institutin për Demokraci "Societas Civilis" me titull "Arsimi i detyrueshëm i mesëm - nga një ide e mirë për të përsosur zbatimin" shprehet nevoja për reforma substanciale në arsimin e mesëm, me pjesëmarrjen më të madhe të iniciativave të qeverisë dhe sektorit të biznesit për të futur arsimin e mesëm të detyrueshëm. Vetëqeverisja lokale ku është lënë zbatimi i ligjit, nuk mundet në vetvete t'i përgjigjet të gjitha sfidave. Nëse nuk ofrohen burime shtesë dhe kapacitete për njësitë e vetëqeverisjes lokale, mund të lindë një proces i ri-centralizimit ciklik në fushën e arsimit.

Reformat në arsim dhe sfidat në Maqedoni

Sa i përket reformave në arsim në Maqedoni, ata janë përcjellë me shumë debate, pajtime dhe mospajtime nga më të ndryshmet. Testimi i jashtëm është njëra nga reformat më të debatuar në kohën e fundit. Nxënësit dhe prindërit ankohen se lëndët kanë pyetje qesharake, kontradiktore dhe jo mirë të formuluar, prandaj edhe shprehin habi se si këto teste mund të bëjnë matjen e dijes?! Profesorët gjithashtu reagojnë. Ata janë të mendimit se këta teste nuk janë tregues i besueshëm i njohurive për shkak se vlerësimi përfundimtar përfshin edhe njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe aktivitetet jashtëshkollore. Nga ana tjetër, testimi i jashtëm nuk mund të kontrollojë të arriturat nga aktivitetet, projektet, hulumtimet, qëndrimet dhe tipare të karakterit. Nxënësit meritohet që kanë zënë vendet e para në garat shkollore, komunale dhe shtetërore, nuk stimulohen. Është e njëjtë me mësuesit. Ata vazhdimisht dëgjojnë dënime në lidhje me të dhënat kontradiktore që dalin nga rezultati i testimit të jashtëm krahasuar me vlerësimin të cilin për lëndë të caktuar e fiton nxënësi gjatë vitit shkollor.

Si rrjedhojë, mësime dhënësit kërkojnë që të rishikohet sistemi i zhvillimit profesional dhe i karrierës i mësime dhënëse dhe të hiqen dispozitat ligjore të cilat lidhin sistemin me rezultatet e testimit të jashtëm, dhe të bëhet rishikimi i kurrikulave për arsimin fillor dhe të mesëm për të forcuar cilësinë në sistemin arsimor në kurriz të sasisë. Testimi i jashtëm është një nga mënyrat për të kontrolluar shkallën e përmbushjes së standardeve në arsim në shumë sisteme arsimore. Testimi i tillë është kryer në mënyrë që të shqyrtojë objektivat arsimore në nivel kombëtar dhe strategjitë didaktike të arritura.

Sërish, numri më i madh i ankesave kanë të bëjnë me formulimin e testeve, sepse shkaktojnë situata stresuese tek fëmijët. Sipas njohësve të situatave në arsim, i gjithë projekti është zbatuar pa ndonjë bazë të fortë shkencore. Realizimi jo i mirëfilltë i këtij projekti rezulton me implikime në suksesin dhe mundësitë për arsimim të mëtejshëm të nxënësve si dhe cënon autoritetin e mësuesit dhe besueshmërisë, zhvillimin e tij profesional dhe të karrierës.⁶

⁶ <https://faktor.mk/reformi-vo-obrazovanieto-site-nezadovolni-ama-vazhno-da-se-turka/>

Nga ana tjetër, punonjësit e arsimit në Maqedoni kanë përshëndetur vendimin e dikasterit të arsimit për të bërë reforma thelbësore në arsimin fillor. Ata theksojnë se reformave duhet t'u paraprijë një studim i thellë që më vete do të gërshetojë gjendjen në institucionet arsimore, rikualifikimin e kuadrit mësimor, përpunimin e teksteve shkollore, si dhe përgatitjen e një plan-programi që do të jetë në përputhshmëri me realitetin e botës elektronike, në të cilën zhvillohet nxënia e dijes tani dhe veçanërisht në të ardhmen. Sipas këtyre ndryshimeve parashihet shkurtimi i lëndëve mësimore, si dhe orari mësimor.

Risi tjetër është dhe ajo se nxënësit e ciklit të ulët të arsimit fillor, nuk do të jenë të angazhuar me detyra shtëpie, por të gjitha detyrat do të realizohen brenda orëve të mësimin, kurse një orë parashihet të zgjasë 55 minuta duke pasur dhe nga 15 minuta pushim brenda orëve mësimore.

Në këtë drejtim, Teuta Zllatku mësimdhënëse në klasat e ciklit të ulët të arsimit fillor për Radion Evropa e Lirë thotë se reformave duhet t'u paraprijë një studim thelbësor që ata mos mbeten vetëm si orvatje për të përmirësuar arsimin.

“Në sistemin arsimor në Maqedoni kemi probleme dhe defekte shumë të mëdha, duke filluar nga tekstet shkollore, kushtet në shkolla, më pas paraqiten më shumë probleme rreth implementimit të programeve mësimore dhe projekteve, të cilat nuk janë të përshtatshme për moshën e fëmijëve. Të gjitha këto reforma duhet të shohiten mirë dhe për to të hapet një debat i mirëfilltë nga personalitetet më kompetente”, thotë Zllatku.

Nga ana tjetër, Gorica Ilioska, e cila punon për më shumë se tri dekada si mësimdhënëse në Shkup, për Radion Evropa e Lirë thotë se zvogëlimi i lëndëve mësimore, përkatësisht pothuajse përgjysmimi i tyre, në asnjë mënyrë nuk do të thotë se nxënësit do të mësojnë më pak. Sipas saj, ata zbarkohen nga presioni që të sigurojnë nota të larta të më shumë mësimdhënës dhe arrijnë të futen në esencën e mësimave, të cilat do t'u shërbejnë në jetën e përditshme në të ardhmen.

“Një nga faktorët kryesorë se pse vite me radhë gjendemi në fund të vendeve të Evropës, mos të them të botës sa i përket cilësisë së arsimit, është ajo se në Maqedoni u instalua praktika që fëmijët si detyrim parësor të kenë mësimin për të siguruar notë më të lartë që të shkojnë në fakultet dhe të zërë një vend pune në administratë shtetërore”.

“Aspak nuk mbahej llogari për afinitetet e nxënësve, përgatitjen e tyre sipas aftësive për tregun e punës. Me rëndësi të veçantë është dhe fakti se me këto reforma parashihen mjete për laboratorë profesionalë ku nxënësit do të mund të praktikojnë atë që mësojnë. Uroj që kjo mos mbetet në letër”, thotë ajo.

Ndërkaq, kryetari i Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptarë në Maqedoni, Nuhi Dardhishta, në një bisedë për Radion Evropa e Lirë ngre shqetësimin se gjatë përpilimit të reformave nga dikasteri i arsimit, fare nuk është konsultuar shoqata që përfaqëson, duke theksuar se reformat duhet të përmbajnë dhe krijimin e kushteve të barabarta si në shkollat maqedonase, ashtu edhe në ato shqipe.

“Kushtet nuk janë të njëjta mes shkollave shqipe dhe atyre maqedonase. Në qytet, në aspektin e objekteve dallimi nuk është aq i madh sa në viset rurale, ku shkollat shqipe janë në gjendje të mjerueshme, ku mungojnë dhe gjërat elementare”.

“Shkollat në gjuhën shqipe, sidomos në komunën më të populluar të Çairit të Shkupit, komuna më e mbi populluar në Evropë me mbi 18 mijë banorë, në një metër katrorë në çdo klasë ka mbi 30 nxënës. Kështu që duhet të zvogëlohet numri i nxënësve, nga një klasë duhet të hapen dy klasë me rreth 20 nxënës ashtu siç është rasti në shkollat maqedonase”, thotë Dardhishta.

Ndryshe nga ministria e Arsimit dhe Shkencës së Maqedonisë, kanë njoftuar se po shqyrtojnë dhe mundësitë për tërhequr nga sistemi arsimor programet e Kembrixhit, në fakt për rishikuar nëse ky sistem i avancuar i arsimit të përdoret të paktën në disa lëndë apo nivele të caktuara të arsimit.

Lidhja e Odave Ekonomike e Maqedonisë në vazhdimësi ka theksuar se sistemi arsimor jociësor ka bërë që në Maqedoni pjesa më e madhe e të rinjve, edhe pse të diplomuar, nuk janë konkurrues në tregun e punës për shkak të moskualifikimit në më shumë drejtime të caktuara.⁷

Sipas qeverisë, - Qeveria e Republikës së Maqedonisë është thellësisht e bindur për nevojën dhe nuk do të devijojë nga zbatimi i reformave qëllimi përfundimtar i të cilave është avancimi i arsimit në të gjitha nivelet në arsimin parashkollor, fillor, arsimin e mesëm dhe të lartë, domethënë përfaqësimin e konceptit të kualifikimeve të cilësisë së lartë.

⁷ <https://nezavisen.mk/mk/vesti/2018/01/17754/>

Republika e Maqedonisë nuk ka burime të pasura natyrore dhe për këtë arsye në ekonominë globale botërore dhe nevojat bashkëkohore të tregut të punës mund të konkurrojnë vetëm me kuadro të cilësisë së lartë dhe të shkolluara fuqishëm. Qëllimi i reformave të propozuara në arsim është krijimi i një bërthame të qëndrueshme të qytetarëve të arsimuar të cilët do të jenë forca lëvizëse e zhvillimit socio-ekonomik.

Provimi shtetëror në institucionet e arsimit të lartë është një nga ato masa e cila aplikohet në një numër të madh të vendeve që karakterizohen nga një zhvillim i shpejtë dhe i qëndrueshëm ekonomik. Propozim vendimi për provimin shtetëror të cilin ne e ofrojmë është përshtatur me karakteristikat e sistemit të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë

Me paketin e reformave pedagogjike parashikohet përforcim i kapaciteteve të kuadrove arsimore ekzistuese dhe të ardhshme në arsimin parashkollor, arsimin fillor dhe të mesëm, nëpërmjet krijimit të një Akademie për mësues, përmirësimin e programit arsimor për edukimin e mësuesve, duke futur një sistem të trajnimit të vazhdueshëm. Gjithashtu, parashikohet zhvillimi profesional dhe i karrierës së mësuesve përmes precizimit të kategorive mësues mentor dhe mësues këshilltar, i shoqëruar nga stimuli shtesë financiar, respektivisht rritjen e pagës mujore të mësuesve. Në kuadër të kësaj propozohet një sistem i licencimit të mësuesve që do të jetë obligativ për mësuesit e ardhshëm, por nuk do të jetë i detyrueshëm për mësuesit ekzistues, të cilët në qoftë se dëshirojnë të kalojnë nëpër procesin e licensimit, paga do t'u rritet për 3.000 denarë në muaj.

Nga aspekti i motivimit të nxënësve të mirë, do të bëhet selektimi i nxënësve më të mirë dhe stimulimin e vazhdueshëm i tyre përmes bursave për arritjen e suksesit më të lartë. Për studentët më të mirë të fakulteteve pedagogjike dhe drejtimet mësimore lartësia e bursës do të jetë së paku 50% e neto rrogës mesatare në vend, ndërsa lartësia e bursës gjatë edukimit profesional në Akademinë e mësuesve do të jetë 100% e neto rrogës mesatare mujore.

Propozohet edhe një koncept të ri për edukim dhe selektim të kuadrit cilësor menaxherial i cili do të menaxhojë shkollat, përmes një trajnimi cilësor dhe dhënien e provimit për drejtor, transparencë në dhënien e provimit dhe mbindërtimin e vazhdueshëm obligativ arsimor.⁸

⁸ <http://mon.gov.mk/index.php/AL/2014-07-23-14-03-25/vesti-i-nastani-alb/434-paket-reformi-al>

Analizë e strategjisë arsimore të Maqedonisë 2018-2025

Kur kemi të bëjmë me strategjitë e zhvillimit të arsimit në vend, duhet të cekim se në dekadën e fundit janë përpiluar disa strategji të tilla të cilat kanë dështuar në realizimin e objektivave të paracaktuara, kryesisht për shkak të mungesës së analizave paraprake dhe shumë të nevojshme, për shkak të kuadrit jo mirë të trajnuar.

Gjithashtu, ndryshimet e shpeshta në vendimmarrjen e MASH, të cilat kanë ndodhur për vite, janë një nga treguesit që shteti i kushton pak vëmendje arsimit. Kjo nuk duhet të ndodhë sidomos tani në një kohë kur Maqedonia po i afrohet BE-së, ku është një kërkesë që shtetet të kenë zhvilluar një sistem kërkimi shkencor dhe të pavarur nga politikat ditore.

Sidoqoftë, në strategjinë për arsim të Republikës së Maqedonisë janë përcaktuar edhe fushat kryesore ku edhe do të përqendrohet kjo strategji. Në përgjithësi kjo strategji parasheh që të analizohen sfidat në sektorët në vijim:

- Arsimin parashkollor
- Arsimin fillor
- Arsimin e mesëm
- Arsimin dhe trajnimin profesional
- Arsimin e lartë, hulumtimet dhe inovacionet
- Arsimin joformal dhe atë për të rritur
- Si dhe zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë

Pas analizës së secilës nga këto pika më lart, në strategjinë parashihi përparësitë dhe rezultatet e pritshme nga zbatimi i strategjisë së arsimit. Është e një rëndësie shumë të madhe zbatimi i pikës së fundit e cila ka të bëjë me zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë, ngase edhe në strategjitë e mëhershme pikat e ngjashme të propozuara nuk janë realizuar dhe nuk janë ndërmarrë masa për analiza më të thella për shkaqet dhe arsyet e dështimit të zbatimit të strategjisë.

Siç edhe u cek më herët, problemet të cilat lindin në dështimin e zbatimi të strategjive në arsim në Republikën e Maqedonisë zakonisht kanë ndodhur për shkak të jostabilitetit politik dhe ndryshimeve të shumta në strukturat udhëheqëse në Ministrinë e arsimit, si dhe për shkak të

planifikimeve të dobëta dhe jo mirë të analizuara të reformave të ndërmarra nga ana e zyrtarëve kompetent, të cilat më vonë kanë dhënë rezultate jo të volitshme dhe kanë ngjallur reagime nga më të ndryshmet nga ana e nxënësve, prindërve dhe mësimeve.

Gjithashtu duhet potencuar se Strategjia e arsimit në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2018-2025 dhe Plani i veprimit i saj u hartuan me përkrahjen financiare dhe teknike të Bashkimit Evropian nëpërmjet një procesi këshillimesh të gjera dhe të pjesëmarrjes, i cili u zhvillua me anë të një numri të madh takimesh, diskutimesh, debatesh e konferencash gjatë fazave të ndryshme të përpilimit të strategjisë, më saktësisht, që nga përcaktimi i sfidave dhe përparësive e deri te formulimi i tekstit përfundimtar.⁹ Kjo na jep shpresë se me përdorimin e modeleve bashkëkohore dhe përvojave të mira do të arrihet të rritet cilësia e arsimit në Maqedoni, do të mënjanohej problemet me të cilat ballafaqohen institucionet e arsimit në vend dhe do të merren parasysh analizat e ekspertëve të fushës së arsimit përpara aplikimit të reformave të reja në këtë fushë.

⁹ Strategjia e arsimit për periudhën 2018-2025, f.8

ANALIZA E POLITIKËS ARSIMORE NË SHQIPËRI

Vështrim i përgjithshëm teorik mbi arsimin në Shqipëri

Reforma arsimore është shndërruar në një ndër çështjet më të rëndësishme për Shqipërinë. Shqipëria doli nga një ekonomi e mbyllur e planifikimit qendror në një ekonomi të tregjeve globale dhe nga një regjim politik i mbyllur autoritar në një regjim më të hapur. Në ekonomitë moderne, niveli dhe cilësia e arsimit ndikon në mundësinë e gjetjes së një vendi pune duke ndikuar njëkohësisht edhe në nivelin e të ardhurave. Arsimi rrit mobilitetin social duke qenë se sa më të arsimuar të jenë njerëzit aq më të mëdha janë shanset e tyre për të siguruar një kualifikim të mëtijshëm në vendet e tregut të punës. Nga ana tjetër, në ekonomitë moderne, mungesa e arsimit përbën një faktor të rëndësishëm për varfërinë. Kështu, duke qenë se pabarazitë në mundësitë për arsimim kontribuojnë në një varfëri strukturore dhe të varfërit, fshatarët apo grupet të tjera të gjetur në disavantazh ndodhen të përjashtuar nga njëri prej mjeteve më të rëndësishëm që çon drejt integritit social dhe përparimit ekonomik.

Arsimi gjithashtu luan një rol shumë të rëndësishëm në përcaktimin e ideologjisë kombëtare, formimit të identitetit dhe nocioneve të qytetarisë. Për pasojë, përpjekjet për reformimin e sistemit arsimor duhet të mbështeten në një gamë vlerash dhe qëndrimesh të shpallura apo të pashpallura, përveç importimit të praktikave të ripunimit të programeve mësimore, të metodave të vlerësimit dhe të formave të përfshirjes dhe angazhimit të komunitetit që mund të mos jenë të përshtatshme për kontekstin socialo- kulturor. Së fundi, por tepër e rëndësishme po të kemi parasysh marrëdhëniet politike delikate dhe rrezikun gjithnjë prezent të një konflikti nacionalist në rajonin e Ballkanit, arsimimi mbart në vetvete potencialin e zbutjes apo acarimit të miteve dhe stereotipeve që kontribuojnë në një konflikt.¹⁰

Ashtu siç ka ndodhur edhe në sistemin tonë shkollor, ndryshimet e shpeshta të bëra këto 20 vitet e fundit, kanë treguar se arsimi është munduar të përshtatet sa të mundë me ndryshimet sociale në vendin tonë, por edhe me ato globale. Këto ndryshime duke mos qenë shumë të

¹⁰ Nora Dudwick & Helen Shahriari, Arsimi në Shqipëri: Qëndrime dhe shpresa në ndryshim, Stevla Tiranë, 2000, f.9

studiara dhe duke qenë se bëheshin në një terren shumë pak të favorshëm nga gjendjes në të cilën sistemi ynë arsimor vinte dhe nga një politizim i tejskajshëm, jo gjithmonë kanë dhënë frytet e duhura dhe janë përceptuar shpesh nga ne si eksperimente.¹¹

Reforma e MSH (Maturës Shtetërore), e cila me konceptimin e saj shumë bashkëkohor synoi të vinte në baraspeshë vlerat e secilit, u kthye në të kundërtën e saj si rezultat i një “pakujdesie “ të vogël. Keqadministrimit. Dëshira për të qenë “humanë” aty ku duhet seriozitet, bëri që administratorë të papërgjegjshëm dhe mësues shumë “zemërgjerë”, të shkatërrojnë vit pas viti këtë sistem duke arritur që edhe nga vetë institucioni i MASH të deklarohet se në MSH kopjohet. Kjo duket si diçka shumë e parëndësishme, por në thelb ajo dëmton rëndë imazhin e sistemit arsimor dhe vlerat që duhet të përçojë ai. Nëse kjo reformë po shfaq problematikën e saj, kjo nuk do të thotë se duhet të kthehemi pas, por të shohim shkaqet e problemeve dhe të gjejmë rrugëzgjdhje më të mira.

Problematika më e bujshme dhe më shqetësuese, sa herë që fillonte viti shkollor kishte të bënte me tekstet. Mungesa e tyre, shitja në mënyrë të paligjshme, cilësia e dobët, sasia e pamjaftueshme dhe mbi të gjitha përmbajtja e tyre dhe ngarkesa e madhe me mangësi në aparatin pedagogjik, u kthyen në një problem tjetër që shoqëroi shkollën gjatë viteve të tranzicionit. Reforma e Altertekstit në arsimin parauniversitar zgjidhi shumë prej problemeve të ngritura. Nuk mund të pretendohet se cilësia dhe niveli shkencor apo pedagogjik i tyre arriti standardet më të larta, por kjo reformë e futi arsimin në një rrugë të mbarë dhe ndikoi shumë në ndryshimin e perceptimit të tekstit, jo si mjet më i rëndësishëm i mësimdhënies, por si një mjet i nevojshëm për nxënësin. Ajo që duket se mbetet e parealizuar në këtë reformë, ka të bëjë me mësuesin. Për sa kohë do të ketë mësues që për probleme të ndryshme apo paqartësi apo edhe gabime shkencore do të shfajësohen se “kështu e ka teksti”, mund të thuhet me bindje se reforma nuk është kuptuar si dhe sa duhet. Problematika e re që shfaq reforma e altertekstit ka të bëjë me tekstet e përkthyer, të cilat vërtet u përkasin shkencave natyrore dhe si të tilla sigurisht që mund të jenë më të mira në cilësi dhe përmbajtje se tekstet që mund të përgatiten nga specialistët shqiptarë, por nuk duhet harruar tradita e vendit nga vijnë këto tekste dhe mbi të gjitha, përkthimi problematik, që shpesh është edhe qesharak dhe amatorial. Shtëpitë botuese nga dëshira për të

¹¹ Nikolin Germenji, Decentralizimi dhe Dekoncentrimi i Kompetencave, Emërimet e Mësuesve dhe Drejtuesve të Shkollave, Këndvështrimi i Nxënësit, Pjesmarrja e Prindërve në Arsim, Problemet e Shkolles, Qeverisja e Shkollës, Sigurimi i Cilësisë dhe Vlerësimi i Performancës

qenë sa më konkuruese në treg harrojnë se nuk kanë të bëjnë me një produkt konsumi, por me një material të rëndësishëm për formimin e brezave. Ajo që mund të dëmtojë seriozisht këtë reformë dhe rrjedhimisht edhe sistemin arsimor, ka të bëjë me interesat klienteliste të shtëpive botuese dhe autorëve të teksteve. Për miratimin e teksteve është mirë të zbatohet një procedurë më e hapur dhe transparente, duke përfshirë më shumë mësuesit si zbatues dhe njohës më të mirë të programeve dhe problematikave shkollore. Kështu mund të shmanget çdo ndikim nga jashtë dhe monopolizim i dëmshëm.

Një reformë nuk mund të kuptohet pa burimet njerëzore që i japin asaj vlerën e vërtetë. Mësuesi është aktori kryesor dhe faktori ë i rëndësishëm që u jep jetë politikave dhe materializon reformat. Duke u ndalur tek zhvillimet e arsimit, nuk mund të mos përmendësh infrastrukturën dhe mjediset shkollore që në këto vite ka ndryshuar shumë. Sot një pjesë e mirë e shkollave të qyteteve të mëdha dhe qendrave të rëndësishme urbane kanë një infrastrukturë bashkëkohore. Është e vërtetë që numri i nxënësve në klasë ka një shpërndarje jo uniforme, por kjo është pasojë e lëvizjeve demografike të mëdha dhe ndryshimeve që po pëson struktura e popullsisë. Problematika në infrastrukturë dhe mjediset shkollore shfaqet tek menaxhimi i tyre.¹²

¹² <http://www.arsimi.al/arsimi-ne-kendveshtrimin-e-reformave/>

Arsimi në Shqipëri pas rënies së komunizmit

Shqiptarët nga vendet e ish-Lindjes komuniste nuk janë të vetmit që shohin me nostalgji disa aspekte të së kaluarës së tyre. Historia e pasluftës së Dytë Botërore në Shqipëri është akoma nën një vështrim të theksuar kritik dhe, në përgjithësi, pas viteve '90-të, prirja ka qenë për të nënvlerësuar arritjet dhe ekzagjeruar dështimet në çdo drejtim. Megjithatë, mjaft studime e analiza për këtë periudhë nxjerrin në pah një lloj konstante “pozitive” për periudhën komuniste, që ka të bëjë me zgjerimin e arsimit në vend.

Çështje kyçe e procesit të zgjerimit, në atë kohë dhe sot, është si të kemi një rritje sasiore, pa pësuar rënie cilësore. Këtu duhen konsideruar dy faktorë: së pari, sistemi arsimor komunist, përfshirë këtu edhe atë universitar, kishte thellësisht baza ideologjike. Përzgjedhja e lëndëve dhe programeve ishte e centralizuar dhe bazuar në një filozofi të qartë pedagogjike, që ishte mësimdhënia me një bazë të gjerë, e cila synonte përgatitjen e një brezi profesionistësh me detyra të qarta shoqërore. Po ashtu, ky sistem ideologjik dhe i centralizuar siguronte edhe absorbimin e studentëve të diplomuar në sistemin publik. Si i tillë, sistemi komunist dukej se krijonte një siguri funksionimi dhe garanci punësimi, gjë që tani është më e rrallë; së dyti, lëndët, sidomos shkencat shoqërore, duke qenë thellësisht të ideologjizuara, vinin theksin në aftësinë e studentëve për të reflektuar dhe përsëritur argumentet e filozofisë zyrtare marksiste, jo të përplasjes së ideve dhe këndvështrimeve të ndryshme. Si rrjedhim, studentët merrnin një formim të gjerë shkencor, por të përcaktuar, që nuk linte vend për vlerësime relative.

Në sistemin aktual, të dyja këto veçori nuk ekzistojnë. Mospasja e një boshti ideologjik është zhvillim pozitiv, por ajo krijon edhe problemin e relativizmit të opinioneve. Jo të gjitha idetë apo teoritë janë të barabarta për nga rëndësia, kështu që relativizmi i tepruar, në vend që të zgjerojë këndvështrimin, mund ta hallakatë atë, ndërkohë mungesa e garancive të punësimit publik krijon një pasiguri për studentët. Megjithatë, kjo situatë nuk është ndonjë veçanti thjesht shqiptare, madje ajo krijon në vetvete një fushë garimi të përbashkët, ku favorizohet cilësia.

Ndryshimi i sistemit në vitin 1990 u pasua dhe me një emigrim masiv, prej të cilit nuk shpëtoi dot as sistemi i arsimit të lartë. Një studim tjetër i vitit 2008 vë në dukje se, pas vitit 1990, pothuajse gjysma e pedagogëve dhe studiuesve të universiteteve shtetërore u larguan nga Shqipëria, por në vitet e fundit, së bashku me rritjen e numrit të universiteteve joshtetërore

(private) dhe punësimin tek to të shumë pedagogëve të rinj, të arsimuar jashtë, po shtohet edhe numri i mësimdhënësve e studiuesve në arsimin e lartë, edhe pse në krahasim me vendet e rajonit dhe vendet e zhvilluara Shqipëria mbetet më prapa.

Masivizimi i arsimit duket të jetë një dukuri botërore, sepse shoqëritë e sotme të shërbimit krijojnë mundësi për të gjithë, kështu, në parim, askush nuk ka të drejtë t'i imponojë individit që të përzgjedhë apo të përcaktojë për të se ç'lloj edukimi duhet të marrë, ku duhet të studiojë, apo cilin cikël studimesh duhet të vazhdojë. Edukimi duket të ketë marrë funksione nga më të ndryshmet në kohën e sotme, sakaq edhe përzgjedhja realizohet në faza të ndryshme të jetës.

Pranimet me konkurs në shkollën e lartë, pas vitit '90-të, duke hequr formalisht procedurat administrative të përzgjedhjes arbitrare, shënuan një hap shumë pozitiv përpara, edhe pse jo në pak raste u shfaqën shenja të manipulimit prej universiteteve shtetërore. Matura Shtetërore më vonë përmirësoi dukshëm procedurat dhe rriti transparencën, duke u konsideruar si praktikë pozitive. Kjo praktikë ka rritur besimin te sistemi dhe konkurrueshmërinë. Vërtet konkurrenca mund të mos jetë e plotë dhe sistemi shfaq herë pas here defektet e veta, por në tërësi nxiten energji pozitive te të rinjtë, rritet vetëbesimi dhe forcohet personaliteti i tyre. Këta janë avantazhe të sistemit të konkurrencës dhe tregut të lirë në edukim. Mundësia për të ndjekur studimet universitare është e jashtëzakonshme në kohën e stome, është “fati” i brezit të sotëm, krahasuar me brezin e kaluar.

Në të kaluarën, universitetet ishin njësi të mbyllura, të izoluara përgjithësisht prej arritjeve akademike shkencore botërore, kryesisht për arsye ideologjike, por edhe në mungesë të plotë të bashkëpunimit me universitete të huaja, si shkëmbim përvojash dhe pedagogësh, organizim të konferencave shkencore ndërkombëtare dhe botim të akteve të tyre. Nën rrethana të tilla, nuk mund të flitet për cilësi në të kaluarën, kur arritjet akademike e shkencore nuk ndaheshin me një komunitet shumë me të gjerë akademik, brenda e jashtë vendit. Universitetet nuk ishin njësi të hapura dhe transparente për të gjithë, sa kohë nuk ofronin shërbime të gjithanshme për studentët dhe stafin, pa website dinamike, pa CV transparente të pedagogëve, ku

përfshihen jo thjesht librat dhe artikujt shkencorë të botuar, por edhe numri i recensave që u bëhen veprave të tyre dhe botime të ndryshme me faktor impakti.¹³

¹³ TONIN GJURAJ, Arsimi i lartë në Shqipëri, e kaluara dhe e tashmja, Panorama, 2012
<http://www.panorama.com.al/arsimi-i-larte-ne-shqiperi-e-kaluara-dhe-e-tashmja/>

Reformat në arsim në Shqipëri

Republika e Shqipërisë po kryen reforma të mëdha në fushën e arsimit, përfshirë zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin Arsimit Parauniversitar 2014-2020. Këto reforma pasqyrojnë prioritetin e lartë të dhënë arsimit në Shqipëri, në perspektivën e integritit në Bashkimin Evropian dhe angazhimeve ndërkombëtare të vendit. Duke parë përtej vitit 2020, këto dhe reforma të tjera pritet të ndihmojnë harmonizimin e sektorit arsimor me Objektivin 4 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ 4) të Agjendës ndërkombëtare 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.¹⁴

Reformat e fundit në arsim dhe debatet që i kanë shoqëruar atë dëshmojnë për një rritje të ndërgjegjësimit të shoqërisë për problemet e arsimit dhe shkollës. Këto probleme duket se i përkasin gjithë shoqërisë dhe jo vetëm një pjese të saj. Reformimi i arsimit tashmë ka prekur të gjithë sistemin arsimor dhe duket se po kulmon me ligjin për arsimin e lartë. Duke qenë se intensiteti i reformave ka qenë i madh dhe koha e kryerjes së tyre, relativisht e shkurtër, janë vënë re dhe po dalin në pah shumë problematika. Është e kuptueshme që vetëm me një reformim të tillë problemet nuk mund të zgjidheshin përnjëherë. Kështu dolën në pah problematikat të cilat në disa raste, nëse nuk trajtohen me seriozitetin e duhur mund të lënë pasojë të rënda në arsimimin e brezave.

Reforma në arsim ka përfshirë legjislacionin, kurrikulat, infrastrukturën, por për fat të keq ende nuk ka një reformë ose ende nuk është vënë në zbatim një reformim i burimeve njerëzore, d.m.th., i kuadrit dhe emërimeve në arsim.

Për sa i përket reformës së kurrikulës, mendoj se janë bërë përparime të dukshme që e sjellin arsimin shqiptar pranë standardeve të vendeve të tjera. Edhe pse duket sikur në shkollë nuk ka ndodhur ndonjë ndryshim i madh, kurrikula e re dhe reformimi tërësor i sistemit parauniversitar ka bërë një revolucion në fushën e arsimit tek ne. Ky reformim nuk duhet parë i ndarë, d.m.th, i copëzuar dhe i rastësishëm, pasi nëse e shohim kështu nuk do të arrijmë të perceptojmë gjithë ndryshimin që është kryer. Duke filluar me sistemin 9-vjeçar, gjimnazin e ri, albertekstin, Maturën Shtetërore, etj.

¹⁴ UNESCO, Seksioni i Politikës Arsimore, Shqipëria, Analiza e Politikës Arsimore: Çështje dhe Rekomandime Raporti i zgjeruar, Paris 2017, f.3

Reformat e kryera shpeshherë edhe me ngut e kanë gjetur të papërgatitur mësuesin për të përballuar gjithë këto ndryshime. Nëse synimi dhe arritja kryesore e kurrikulës së re dhe reformës ka qenë ndryshimi i konceptimit në arsim, pra vënia në qendër e nxënësit, kjo jo nga të gjithë mësuesit është kuptuar, ose është kuptuar në mënyrë sipërfaqësore. Të vendosësh nxënësin në qendër të mësimi nuk do të thotë të mjaftohesh duke përdorur disa teknika mësimdhënieje që në literaturën pedagogjike njihen si “teknika të të mësuarit me në qendër nxënësi”, por duhet të ndryshohet mendësia e mësimdhënies, duhet ndryshuar këndvështrimi. Mësimi dhe shkolla duhet t’i shërbejë nxënësit dhe nëse kjo nuk arrihet misioni mund të quhet i parealizuar, për të mos thënë i dështuar. Ende sot, ka mësues që e shohin nxënësin si objekt dhe jo si subjekt. Harrojnë se tek çdo individ ka një veçori të cilën sistemi arsimor dhe veçanërisht mësuesi duhet ta vërë në dukje. Tek nxënësit shohin problemin dhe jo zgjidhjen; nxënësit i vënë në dukje dobësitë, por jo arritjet. Ky këndvështrim, edhe pse nuk është keqdashës bëhet shkak për krijimin e situatave të pakëndshme në mësim.¹⁵

Sot Shqipëria bën pjesë në grupin e vendeve me kërkesë shumë të madhe për arsimin e lartë, ka një numër studentësh të krahasueshëm me atë të vendeve të BE-së, çka do të thotë se ne e kemi përmbushur objektivin kryesor të strategjisë kombëtare të zhvillimit të arsimit të lartë 2008-2013, liberalizimin dhe pjesëmarrjen. Ndërsa tani cilësia është shpallur si sfidë kryesore dhe afatgjatë për sistemin tonë të arsimit të lartë.

Pavarësisht zbatimit të standardeve europiane në arsimin e lartë në kuadrin politikëbërës dhe legjislativ, në Shqipëri ai është ende larg realizimit konkret të objektivave dhe standardeve të synuara. Komisioni Europian, në Progres Raportin për Shqipërinë për vitin 2014 sa i takon arsimit të lartë, vëren se pak përparim është bërë në reformimin e arsimit të lartë dhe në mbështetjen financiare për zhvillimin e kërkimit dhe inovacionit me qëllim që Shqipëria të bëhet pjesë e Hapësirës Europiane të Kërkimit (KE, 2014: 63-64). Progres raporti sugjeron nevojën për analizë të aftësive dhe profesioneve që kërkohen në treg në nivel kombëtar dhe rajonal, më pas këto gjetje të krahasohen me programet e studimit dhe kurrikulat akademike që ofrojnë universitetet shqiptare. Për më tepër, është e nevojshme të ndërtohet një strategji për mësimin përgjatë gjithë jetës si dhe për arsimin dhe formimin profesional (KE, 2014: 64).

¹⁵ <http://www.arsimi.al/arsimi-ne-kendveshtrimin-e-reformave/>

Gjithashtu, sfida e hapur mbetet zhvillimi cilësor i arsimit të lartë në Shqipëri, tashmë i mirëpranuar nga të gjithë aktorët. Në sferën publike janë bërë disa përpjekje për të nxitur debatin rreth reformimit të sistemit të arsimit të lartë në vend përmes publikimeve të shkrimeve në shtypin e përditshëm, emisioneve televizive, forumeve në platformat online të komunikimit, konferencave shkencore dhe tryezave të rrumbullakëta, si edhe përmes botimeve të eseve apo artikujve analitikë lidhur me progresin e deritanishëm dhe sfidat e mëtejshme të arsimit të lartë.

Sa i takon politikëbërjes, në janar të vitit 2014 qeveria ndërmori nismën e ngritjes së Komisionit për Reformën e Arsimit të Lartë në vend, të përbërë nga një grup ekspertësh të sferës së akademisë dhe kërkimit me qëllim përgatitjen e një reforme të thellë të sektorit, duke përfshirë skemat e financimit dhe qeverisjes së universiteteve, raportin publik dhe jopublik, kërkimin shkencor dhe zhvillimin e kapaciteteve në përputhje me kërkesat e tregut të punës e të shoqërisë shqiptare.

Reformimi i arsimit të lartë kërkon që arsimit të konsiderohet si vazhdimësi dhe jo i copëzuar në cikle të ndryshme, duke vënë theksin te mësimi përgjatë gjithë jetës, si dhe strategjitë arsimore të përputhen me strategjitë e zhvillimit të vendit (Rrokaj, Sh., 2013:1-3). Këto procese kanë ndikuar rrënjësisht në hapësirën universitare në Shqipëri dhe kanë nxjerrë sfida të reja, si kapërcimi i dikotomisë arsim i lartë publik-privat dhe ripozicionimi i universiteteve në Shqipëri në përputhje me kushtet e shoqërisë dhe ekonomisë së tregut.¹⁶

¹⁶ Juljana Laze, SFIDAT E SISTEMIT TË LARTË ARSIMOR NË SHQIPËRI DREJT ZONËS EUROPIANE, Tiranë, 2015

Analizë e strategjisë arsimore të Republikës së Shqipërisë 2014-2020

Strategjia arsimore e Shqipërisë për periudhën kohore 2014-2020 paraqet vizionin për arsimin dhe skicon rrugën për përmbushjen e tij, përmes plotësimit të përparësive strategjike që janë caktuar për këtë sektor. Sikundër shihet, strategjia e trajton sistemin arsimor në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe i adreson konkretisht këto përparësi. Njëherazi, ajo reflekton konsensusin ndërmjet komunitetit akademik, profesionistëve të arsimit, shoqërisë civile, grupeve të interesuara për arsimin dhe publikut të gjerë.

Në këtë strategji janë vënë disa pika prioritare të cilat duhet adresuar në mënyrë që të mund të ngrihet në një nivel më të lartë sistemi arsimor në Maqedoni dhe në Shqipëri. Ato janë si vijon:

- Organizimi dhe funksionimi
- Paraqitje e kontekstit të përparësive – sfidat përpara
- Kapacitetet drejtuese dhe menaxhuese
- Cilësia e arritjeve dhe niveli i kushteve të nxënies
- Sigurimi i cilësisë së arritjeve
- Problematika e burimeve njerëzore
- Përsosja e qeverisjes, e udhëheqjes dhe e menaxhimit të kapaciteteve dhe burimeve
- Nxënie gjithëpërfshirëse dhe cilësore
- Sigurimi i cilësisë së arritjeve bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e BE-së
- Përgatitja dhe zhvillimi profesional bashkëkohor i mësuesve dhe i drejtuesve¹⁷

Në bazë të kësaj strategjie do të tentohet të bëhet përmirësimi i arsimit në Shqipëri në përgjithësi, mënjanimi i problemeve të deritanishme dhe krijimi i një sistemi bashkëkohor arsimor i cili do t'i paraprin ndryshimeve shoqërore në të ardhmen dhe i cili do të jep efektin e vet pozitiv në edukimin dhe arsimimin e shoqërisë.

¹⁷ Strategjia e Zhvillimit të Arsimit të Republikës së Shqipërisë 2014-2020

ASPEKTI KOMPARATIV I POLITIKAVE ARSIMORE NË MAQEDONI DHE NË SHQIPËRI

Raportet vlerësuese për arsimin në Maqedoni

Duke folur për reformat në arsim dhe zbatimin e tyre, situata aktuale në këtë sektor thekson se institucionet shtetërore nuk arriti të marrë parasysh të gjitha pasojat e aplikimit të njëjtë, duke treguar kapacitet të pamjaftueshëm të planifikimit, organizimit dhe zbatimit. Kjo mund të konstatohet nga të dhënat e publikuara nga raporti i auditimit të titulluar "Efektiviteti i programeve dhe masave që synojnë zhvillimin e arsimit të mesëm", zbatuar nga Auditori i Shtetit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, ku ajo ka qenë istakneti mëposhtme gjetjet:

- Mungesa e analizës së rezultateve të testimit të jashtëm, problemet e shkollave me borxhe në bazë të transportit të lirë dhe investimeve të zgjeruara të infrastrukturës në arsim. Në vitin 2015, shkollat i detyroheshin 4.9 milion euro vetëm në bazë të transportit të nxënësve.
- Nga gjithsej 583 raste pas dy garave të botuara (2009 dhe 2010), për lëshimin e teksteve shkollore për arsimin e mesëm në shkollat profesionale, janë miratuar 324 tekste shkollore.

Në vijim janë rekomandimet e Auditorit Shtetëror:

- "Zbatimi i plotë i projektit të librave të lirë, përcaktimi i nevojës për tekstet shkollore dhe furnizimi i shkollave me numrin e nevojshëm të studentëve dhe fillimi i transportit të lirë të projektit".
- "Monitorimi i zhvillimit profesional dhe profesional të mësuesve, si dhe krijimi i një sistemi të trajnimeve".
- "Forcimi i përfshirjes së kompanive në krijimin e kurrikulave në kuadër të forcimit të lidhjes ndërmjet shkollave profesionale dhe tregut të punës".
- "Reformat profesionale të arsimit të mesëm profesional sipas nevojave të deklaruara të tregut të punës".

Në një analizë politike në Institutin për Demokraci "Societas Civilis" me titull "Arsimi i detyrueshëm i mesëm - nga një ide e mirë për të përsosur zbatimin" udhëzues nevojën për

reforma substanciale në arsimin e mesëm, me pjesëmarrjen më të madhe të iniciativave të qeverisë dhe private vendore nga ana e sektorit të biznesit për të futur arsimin e mesëm të detyrueshëm. Vetqeverisja lokale ku është lënë zbatimi i ligjit, nuk mundet në vetvete t'i përgjigjet të gjitha sfidave. Nëse nuk ofrohen burime shtesë dhe kapacitete për njësitë e vetëqeverisjes lokale, mund të lindë një proces i ri-centralizimit ciklik në fushën e arsimit.

Raportet vlerësuese për arsimin në Shqipëri

Sipas një raporti të realizuar nga UNESCO mbi arsimin në Shqipëri, vihet në dukje se Shqipëria ka përparuar në mënyrë të dukshme me gjithë sfidat e konsiderueshme. Pas shembjes së komunizmit dhe strukturave autoritare në sistemin e saj arsimor, dhe duke ndjekur një rrugë të vazhdueshme të përafrimit me normat dhe standardet më të zgjeruara ndërkombëtare, sektori i arsimit është tashmë në prag të suksesit me nivele më të larta të gjithëpërfshirjes sociale dhe me arritje më të larta të nxënësve. Reformat dhe strategjitë më të fundit në arsim duhet të zbatohen dhe përkrahen plotësisht në mënyrë që të shënohen përmirësime të matshme në çështjet që lidhen me paanësinë, efikasitetin, cilësinë, aksesin dhe gjithëpërfshirjen në arsim.

Sistemi arsimor shqiptar është duke kaluar ndryshime të rëndësishme dhe ka qenë gjatë dy dekadave të fundit, më së shumti në perspektivën e integritit në BE. Shumë nga programet dhe politikat që lidhen me mësuesit dhe drejtuesit e shkollës janë relativisht të reja, dhe efektshmëria e tyre do të duhet të monitorohet dhe të vlerësohet. Kështu, konsultimi, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informatave me mësuesit, drejtorët dhe aktorët kryesorë do të jenë vendimtare për suksesin e këtyre reformave.

Gjithnjë sipas këtij raporti dhe duke u bazuar në faktet e prezantuara më lartë, dalin katër çështje të përbashkëta të politikës të cilat kërkojnë përpunim të mëtejshëm dhe vëmendje të politikës:¹⁸

- a. Përmirësimi i shkëmbimit të informacionit, i komunikimit dhe i transparencës;
- b. Ndërtimi i një shoqërie më të barabartë përmes arsimit gjithëpërfshirës;
- c. Promovimi i institucioneve dhe i infrastrukturës së fortë shkollore; dhe
- d. Forcimi i kapaciteteve për monitorimin dhe vlerësimin e reformave në arsim.

¹⁸ UNESCO, Seksioni i Politikës Arsimore, Shqipëria, Analiza e Politikës Arsimore: Çështje dhe Rekomandime Raporti i zgjeruar, Paris 2017, f.177

Sipas një raporti tjetër të realizuar nga Banka Botërore, si pika prioritare në të cilat duhen fokusuar institucionet e arsimit në Shqipëri janë:

- Hartimi i reformës arsimore
- Transparenca dhe përgjegjësia
- Rindërtimi dhe rehabilitimi i shkollave
- Reforma e programit mësimor dhe librave shkollore
- Cilësia e mësimdhënies dhe zhvillimi profesional
- Marrëdhëniet dhe përgjegjësitë institucionale
- Rritja e barazisë dhe qasjes
- Monitorimi

Analiza komparative e politikave arsimore

Ndryshimi shoqëror është proces permanent në çdo segment të sistemit shoqëror. Procesi i ndryshimit rrjedh nga vetë natyra e jetës shoqërore, ose thënë ndryshe nga vet veprimtaria e perditshme dhe dinamika e njeriut. Procesi i ndryshimit shoqëror realizohet nëpërmjet lëvizjeve shorierore, që realizojnë zhvillimin e shoqërisë në menyrë të evolucionit dhe revolucionit, të zhvillimit hap pas hapi dhe atij të përnjëhershëm.¹⁹

Të gjitha shtetet e Ballkanit përfundimor kaluan nëpër ndryshime shoqërore dhe politike, të cilat sot e kësaj dite janë aktive dhe që njihen me emrin tranzicion. Edhe Maqedonia po edhe Shqipëria akoma nuk e kanë përfunduar këtë tranzicion shoqëror dhe i njëjti ka ndikuar ndjeshëm edhe në sistemin arsimor, i cili nuk mundeshe t'i rezistojë këtyre proceseve.

Nga të dhënat e cekura më lartë, mund të vërejmë se probleme të ngjashme me arsimin vërehen tek ty dyja shtetet, e që kanë të bëjnë me politizimin e kësaj fushe, duke i kapur institucionet dhe duke ndikuar në vendimmarrjen e tyre. Më pastaj cilësia e dobët e teksteve shkollore dhe objektet e vjetruara shkollore përbëjnë një pasqyrë se deri në çfarë mase ka depërtuar neglizhenca politike dhe shoqërore ndaj arsimit në Shqipëri dhe Maqedoni. Gjithashtu, të dy shtetet kanë vështirësi të mëdha në procesin e reformave e sidomos në aspektin e zbatimit të testimit të jashtëm të nxënësve. Edhe pse për shkaqe të ndryshme, reforma e tillë është vënë në pikëpyetje, ndërsa me të edhe serioziteti i qeverive për reformimin e arsimit sipas rekomandimeve të BE-së.

Nga aspekti i zbatimit të Bolonjës në arsim, të dy shtetet kanë vënë në lëvizje institucionet në përshtatjen e tyre ndaj procesit të Bolonjës, i cili është proces i reformave Evropiane, qëllimi i të cilit ishte themelimi "Hapësirës së edukimit të lartë evropian" deri në vitin 2010. Është një proces i pazakontë i strukturuar dhe udhëhequr nga 46 shtete që participojnë në të. Ky proces u mundëson studentëve që të studiojnë atë që duan dhe aty ku duan pa marrë parasysh se ku ata i kanë filluar studimet dhe ku dëshirojnë të mbarojnë.²⁰

¹⁹ Jonuz Abdullahi, Ndryshimet sociale dhe tranzicion, CRPA & Arberia Design, Tetovë 2008, f.17

²⁰ Dashmir Idrizi, Sfidat e arsimit sipëror në gjuhën shqipe në RM, Tetovë 2013, f.60

Politika arsimore dhe strategjitë e realizimit të saj tregojnë se Bashkimi Evropian karakterizohet nga një shumëllojshmëri sistemesh arsimore të shteteve anëtare, me tendencë që të realizojë objektivat e përbashkëta të përcaktuara me Traktatin për BE-në. Veprimi i BE-së në fushën e arsimit, ngritjes profesionale dhe rinisë bazohet në objektivat e përcaktuara në nenet 126 dhe 127 të traktatit të Mاستrihtit nga ku mund të shihet se roli i Komunitetit është që të kontribuojë në zhvillimin e bashkëpunimit në mes shteteve anëtare, madje edhe duke mbështetur dhe plotësuar veprimtaritë e tyre në fushën e arsimit. BE-ja ka në dispozicion parime drejtuese dhe programe rreth Politikave të Arsimimit. Instrumenti i harmonizimit përmes parimeve drejtuese sot përkufizohet brenda fushës së njohjes së diplomave profesionale ose të atyre të shkollave të larta dhe brenda koordinimit të të drejtave ligjore dhe atyre administrative të vendeve pjesëmarrëse rreth pranimi dhe ushtrimit të veprimtarive të pavarura. Maqedonia dhe Shqipëria si dy shtete të cilat kanë aspirata t'i bashkëngjiten BE-së, duhet bashkëpunuar në mes vete në sferën e arsimit me qëllim të përmbushjes së detyrimeve dhe ngritjes së kapaciteteve të nevojshme profesionale, me qëllim të harmonizimit më të lehtë gjatë procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

SHPALOSJA E REZULTATEVE NGA HULUMTIMI

Në kuadër të hulumtimit në mënyrë që të arrijmë deri tek rezultatet dhe informatat e duhura, përveç përdorimit të metodologjive hulumtuese të cekura më sipër, edhe atë duke nisur me analizën e teksteve dhe dokumenteve zyrtare të institucioneve relevante në Maqedoni dhe Shqipëri, analizën e teksteve shkollore dhe literaturës vendore dhe asaj ndërkombëtare, duke bërë një analizë krahasuese në mes të dy shteteve, është realizuar pyetësi i cili është plotësuar nga punonjësit e arsimit dhe palët e prekura nga arsimi siç janë nxënësit dhe prindërit.

Rezultatet nga hulumtimi i realizuar

Tabela e mëposhtme ofron statistikën përshkuese të të dhënave të marra nga anketa e realizuar. Nga aty rezulton që gjithsej të anketuar kemi pasur 149 persona, ku në disa pyetje të anketuarit nuk kanë dhënë përgjigje. Mesatarja dhe devijimi standard ofrojnë informacion rreth zhvendosjes që mund të ketë mes përgjigjeve të të anketuarve.

Tabela 1 – Statistika përshkuese e të dhënave

Statistika deskriptive					
	N	Minimum	Maksimum	Mesatare	Dev, standard
Kënaqësia nga reformat e realizuara në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit	149	1.0	4.0	2.523	.9414
Realizimi i reformave në mënyrën e duhur	149	1.0	4.0	2.235	.8414
Kënaqësia nga reformat sipas modelit të Kembrixhit	148	1.0	4.0	2.324	.8746
Modeli i Kembrixhit a ofron arsim kualitativ	149	1.0	4.0	2.443	.9613
Çka ju pëlqen më së shumti në arsimin sipas modelit të Kembrixhit	147	1.0	5.0	2.782	1.4875

A mendoni se zbatimi gradual i reformave do të jep një arsim më kualitativ	149	1.0	4.0	2.067	1.0245
Sa mendoni se ndikon rroga e mësimdhënësit dhe kushtet e punës në kualitetin e arsimit në përgjithësi	149	1.0	3.0	1.671	.8091
A mendoni se mësimdhënësit trajtohen në mënyrë të duhur në shoqëri	149	1.0	4.0	2.248	.7790
A mendoni se përzgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet në mënyrë të duhur	149	1.0	4.0	2.664	.7764
Sa mendoni se është implementuar strategjia e arsimit nga ana e qeverisë	148	1.0	4.0	2.338	.8926
Profili juaj si pjesëmarrës në anketë	149	1.0	4.0	1.738	.9472
Valid	145				

Pyetja e parë e pyetësorit kishte të bëj me atë se sa të anketuarit janë të kënaqur me reformat e realizuara nga ana e qeverisë në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit. Gjithsej përgjigje dhanë 149 të anketuar nga ku:

- 19 prej tyre apo 12.8% deklaruan se janë shumë të kënaqur
- 61 të anketuar apo 40.9% deklaruan se pjesërisht janë të kënaqur
- 41 të anketuar apo 27.5% ishin pak të kënaqur dhe
- 28 prej tyre apo 18.8% aspak nuk ishin të kënaqur

Tabela dhe grafikoni i mëposhtëm ofron të dhënat e detajuara.

Tabela 2. Kënaqësia nga reformat e realizuara në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit					
		Frekuenca	Përqindje	Përqindje valide	Përqindje kumulative
Valid	Shumë i kënaqur	19	12.8	12.8	12.8
	Pjesërisht i kënaqur	61	40.9	40.9	53.7
	Pak i kënaqur	41	27.5	27.5	81.2
	Aspak	28	18.8	18.8	100.0
	Total	149	100.0	100.0	

Kënaqësia nga reformat e realizuara në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit




Figura 1. Kënaqësia nga reformat e realizuara në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit

Pyetja e dytë e pyetësorit kishte të bëjë me atë se nëse reformat në arsim janë realizuar në mënyrë të duhur, duke siguruar trajnime paraprake dhe pajisje të mirëfilltë me materiale, rezulton që:

- 60 të anketuar apo 40.3% e tyre pjesërisht pajtohen me këtë konstatim
- 50 prej tyre apo 33.6% nuk pajtohen
- 31 prej tyre apo 20.8% pajtohen me këtë konstatim dhe
- 8 prej tyre apo 5.4% nuk dinin çfarë përgjigje të japin.

Tabela 3. Realizimi i reformave në mënyrën e duhur					
		Frekuenca	Përqindj e	Përqindje valide	Përqindje kumulative
Valid	Po	31	20.8	20.8	20.8
	Pjesërisht	60	40.3	40.3	61.1
	Jo	50	33.6	33.6	94.6
	Nuk e di	8	5.4	5.4	100.0
	Total	149	100.0	100.0	



Figura 2. Realizimi i reformave në mënyrën e duhur

Pyetja e tretë e pyetësorit kishte të bëj me atë nëse të anketuarit janë të kënaqur me reformat në arsim sipas modelit të Kembrixhit. Nga rezultatet e fituare prej anketës, rezulton që 32 të anketuar apo 21.6% janë të kënaqur nga reformat sipas modelit të Kembrixhit, 44 të anketuar apo 29.5% prej janë pjesërisht të kënaqur, 64 të anketuar apo 43% nuk ishin të kënaqur ndërsa 8 prej tyre apo 5.4% nuk dinin çfarë përgjigje të jepnin.

Tabela dhe grafikoni në vijim ofron të dhënat e detajuara për këtë.

Tabela 4. Kënaqësia nga reformat sipas modelit të Kembrixhit					
		Frekuenca	Përqindje	Përqindje valide	Përqindje kumulative
Valid	Po	32	21.5	21.6	21.6
	Pjesërisht	44	29.5	29.7	51.4
	Jo	64	43.0	43.2	94.6
	Nuk e di	8	5.4	5.4	100.0
	Total	148	99.3	100.0	
Missing	System	1	.7		
Total		149	100.0		




Figura 3. Kënaqësia nga reformat sipas modelit të Kembrixhit

Pyetja e katërt me radhë e pyetësorit kishte të bëjë me atë nëse modeli i Kembrixhit ofron arsimim më kualitativ. Rezultatet e fituara nga anketa janë si vijon:

- 62 të anketuar apo 41.6% nuk mendojnë se modeli i Kembrixhit ofron arsim kualitativ
- 32 të anketuar apo 21.5% mendojnë se ky model ofron arsim kualitativ
- 37 të anketuar apo 24.8% mendojnë se ky model ofron pjesërisht ofron arsim kualitativ
- 18 të anketuar apo 12.1% nuk dinin.

Tabela 5. Modeli i Kembrixhit a ofron arsim kualitativ					
		Frekuenca	Përqindje	Përqindje valide	Përqindje kumulative
Valid	Po	32	21.5	21.5	21.5
	Pjesërisht	37	24.8	24.8	46.3
	Jo	62	41.6	41.6	87.9
	Nuk e di	18	12.1	12.1	100.0
	Total	149	100.0	100.0	




Figura 4. Modeli i Kembrixhit a ofron arsim kualitativ

Pyetja e pestë me radhë e pyetësorit kishte të bëjë me atë se çka më së shumti u pëlqen në arsimin sipas modelit të Kembrixhit. Të anketuarit u shprehën si vijon: 34 të anketuar apo 22.8% e përmendën interaktivitetin nxënës-mësimdhënës, 45 të anketuar apo 30.2% e tyre prezantimin vizual, 21 të anketuar apo 14.1% përsëritjen e shpeshtë të mësimave, 13 të anketuar apo 8.7% e potencuan se janë materialet mësimore që më së shumti u pëlqejnë ndërsa 34 të anketuar apo 22.8% prej tyre thane se asnjëra nga të lartpërmendurat nuk ju pëlqejnë.

Tabela 6. Çka ju pëlqen më së shumti në arsimin sipas modelit të Kembrixhit					
		Frekuenca	Përqindje	Përqindje valide	Përqindje kumulative
Valid	Interaktiviteti nxënës-mësimdhënës	34	22.8	23.1	23.1
	Prezantimi vizual	45	30.2	30.6	53.7
	Përsëritja e shpeshtë e mësimave	21	14.1	14.3	68.0
	Materialet mësimore	13	8.7	8.8	76.9
	Asgjë nga më sipër	34	22.8	23.1	100.0

	Total	147	98.7	100.0	
Missing	System	2	1.3		
Total		149	100.0		




Figura 5. Çka ju pëlqen më së shumti në arsimin sipas modelit të Kembrixhit

Pyetja e radhës e pyetësorit kishte të bëj me atë nëse zbatimi gradual I reformave do të jep arsim më kualitativ, ku të anketuarit u përgjigjën si vijon: 56 prej të anketuarve apo 37.6% kishin mendim se zbatimi gradual I reformave do të ofroj arsim më kualitativ, 44 prej tyre apo 29.5% menduan se pjesërisht do të ofroj arsim më kualitativ, 32 prej tyre apo 21. 5% mendonin se nuk do jep aspak, ndërsa 17 prej tyre apo 11.4% nuk dinin çfarë përgjigje të jepnin.

Tabela 7. A mendoni se zbatimi gradual i reformave do të jep një arsim më kualitativ					
		Frekuenca	Përqindje	Përqindje valide	Përqindje kumulative
Valid	Po	56	37.6	37.6	37.6
	Pjesërisht	44	29.5	29.5	67.1
	Jo	32	21.5	21.5	88.6
	Nuk e di	17	11.4	11.4	100.0
	Total	149	100.0	100.0	

A mendoni se zbatimi gradual i reformave do të jep një arsim më kualitativ




Figura 6. A mendoni se zbatimi gradual i reformave do të jep një arsim më kualitativ

Pyetja e shtatë me radhë kishte të bëjë me atë nëse rroga e mësimdhënësit dhe kushtet e punës ndikojnë në kualitetin e arsimit në përgjithësi. Nga të anketuarit rezulton që mbi gjysma e tyre apo 81 të anketuar theksuan se rroga dhe kushtet e punës ndikojnë shumë në kualitetin e arsimit. Nga ana tjetër, 36 të anketuar apo 24.2% e tyre theksuan se ndikon pjesërisht ndërsa 32 të anketuar apo 21.5% theksuan se nuk ndikon aspak.

Tabela 8. Sa mendoni se ndikon rroga e mësimeve dhe kushtet e punës në kualitetin e arsimit në përgjithësi					
		Frekuenca	Përqindje	Përqindje valide	Përqindje kumulative
Valid	Shumë	81	54.4	54.4	54.4
	Pjesërisht	36	24.2	24.2	78.5
	Aspak nuk ndikon	32	21.5	21.5	100.0
	Total	149	100.0	100.0	

Sa mendoni se ndikon rroga e mësimeve dhe kushtet e punës në kualitetin e arsimit në përgjithësi




Figura 7. Sa mendoni se ndikon rroga e mësimeve dhe kushtet e punës në kualitetin e arsimit në përgjithësi

Pyetja e radhës e pyetësorit kishte të bëjë me atë nëse mësimeve trajtohen në mënyrë të duhur në shoqërinë. Nga kjo pyetje rezulton që vetëm 26 të anketuar apo 17.4% e tyre theksojnë se mësimeve trajtohen në mënyrë të duhur, 65 të anketuar apo 43.6% theksuan se

pjesërisht trajtohen në mënyrë të duhur, 53 të anketuar apo 35.6% se nuk trajtohen fare si duhet, ndërsa 5 të anketuar nuk dinin përgjigjen.

Tabela 9. A mendoni se mësimdhënësit trajtohen në mënyrë të duhur në shoqëri					
		Frekuenca	Përqindje	Përqindje valide	Përqindje kumulative
Valid	Po	26	17.4	17.4	17.4
	Pjesërisht	65	43.6	43.6	61.1
	Jo	53	35.6	35.6	96.6
	Nuk e di	5	3.4	3.4	100.0
	Total	149	100.0	100.0	



Figura 8. A mendoni se mësimdhënësit trajtohen në mënyrë të duhur në shoqëri

Pyetja e nëntë me radhë kishte të bëjë me atë se nëse përzgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet në mënyrën e duhur. Jo çuditërisht, mbi gjysma apo 85 të anketuar potencuan që kjo gjë nuk bëhet në mënyrën e duhur, 36 të anketuar apo 24.2% theksuan se pjesërisht bëhet në

mënyrën e duhur, ndërsa nga 14 të anketuar apo 9.4% theksuan se bëhet në mënyrë të duhur dhe se nuk dine të japin përgjigje në këtë pyetje.

Tabela 10. A mendoni se përzgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet në mënyrë të duhur					
		Frekuenca	Përqindj e	Përqindje valide	Përqindje kumulative
Valid	Po	14	9.4	9.4	9.4
	Pjesërisht	36	24.2	24.2	33.6
	Jo	85	57.0	57.0	90.6
	Nuk e di	14	9.4	9.4	100.0
	Total	149	100.0	100.0	

A mendoni se përzgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet në mënyrë të duhur




Figura 9. A mendoni se përzgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet në mënyrë të duhur

Pyetja e parafundit e pyetësorit kishte të bëjë me atë se sa është e implementuar strategjia e arsimit nga ana e qeverisë. Nga totali i të anketuarve 68 prej tyre apo 45.6% theksuan se pjesërisht është implementuar, 24 të anketuar apo 16.1% se plotësisht është implementuar, 38 të

anketuar apo 25.5% se aspak nuk është implementuar dhe së fundmi 18 të anketuar nuk kishin njohuri për këtë gjë.

Tabela 11. Sa mendoni se është implementuar strategjia e arsimit nga ana e qeverisë					
		Frekuenca	Përqindje	Përqindje valide	Përqindje kumulative
Valid	Plotësisht është implementuar	24	16.1	16.2	16.2
	Pjesërisht është implementuar	68	45.6	45.9	62.2
	Aspak nuk është implementuar	38	25.5	25.7	87.8
	Nuk kam njohuri	18	12.1	12.2	100.0
	Total	148	99.3	100.0	
Missing	System	1	.7		
Total		149	100.0		




Figura 10. Sa mendoni se është implementuar strategjia e arsimit nga ana e qeverisë

Pyetja e fundit e pyetësorit kishte të bëj me atë se cili është profile i të anketuarve. Nga anketua rezulton që 80 të anketuar apo mbi gjysma ishin mësues, 39 prej tyre ishin prindër, 19 ishin nxënës dhe 11 njohës të rrethanave në arsim. Ky tregues do të jetë i rëndësishëm për pjesën në vijim, ku do të bëjmë krahasim të përgjigjeve të të anketuarve përmes përmes metodës së kryqëzimit të tabelave.

Tabela 12. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë					
		Frekuenca	Përqindje	Përqindje valide	Përqindje kumulative
Valid	Mësues	80	53.7	53.7	53.7
	Prind	39	26.2	26.2	79.9
	Nxënës	19	12.8	12.8	92.6
	Njohës i rrethanave në arsim	11	7.4	7.4	100.0
	Total	149	100.0	100.0	




Figura 11. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë


Kryqëzimi i tabelave

Si pjesë e analizës së hulumtimit praktik përmes pyetësorit, do të përdoret edhe kryqëzimi i tabelave gjegjësisht analizohet përgjigjet e dhëna nga profilet e ndryshme të të anketuarve dhe përgjigjet e tyre, për të bërë krahasim mes tyre.

Në pyetjen e parë se sa janë të kënaqur me reformat e realizuara në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit, rezultojnë që mbi gjysma e mesimdhënësve apo 42 prej tyre janë shumë ose pjesërisht të kënaqur. I njëjti mendim ekziston edhe tek prindërit, ku 21 prej tyre janë shumë ose pjesërisht të kënaqur. Edhe tek nxënësit më shumë se gjysma (12) janë shumë ose pjesërisht të kënaqur. Pra, rezultojnë se gati të gjitha kategoritë janë të këtij mendimi (përfshirë këtu ndoshta kategorinë njohës të rrethanave ku më pak se gjysma janë të këtij mendimi, ku gati gjysma poashtu nuk janë aspak të kënaqur).

Tabela 13. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Kënaqësia nga reformat e realizuara në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit

			Kënaqësia nga reformat e realizuara në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit				Total
			Shumë kënaqur	Pjesërisht kënaqur	Pak kënaqur	Aspak	
Profili juaj si pjesëmarrës në anketë	Mësues		5	37	24	14	80
	Prind		6	15	12	6	39
	Nxënës		7	5	4	3	19
	Njohës i rrethanave në arsim		1	4	1	5	11
Total			19	61	41	28	149



Profili juaj si pjesëmarrës në anketë


Figura 12. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Kënaqësia nga reformat e realizuara në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit

Në krahasim tek pyetja se sa realizimi i reformave në është bërë në mënyrën e duhur, rezulton që 47 prej prindërve të anketuar mendojnë se është bërë si duhet dhe pjesërisht ndërsa 33 se nuk është bërë në mënyrën e duhur. Nga ana tjetër 25 prindër mendojnë se ato janë realizuar si duhet ose pjesërisht janë realizuar si duhet. Tek nxënësit kemi ndarjen në mendime po ashtu ku 10 nxënës janë të mendimit se plotësisht ose pjesërisht janë realizuar ndërsa 14 nxënës se nuk janë realizuar aspak ose nuk kanë dhënë përgjigje. Njohësit e rrethanave në arsim apo thënë ndryshe ekspertët theksojnë se reformat janë realizuar si duhet ose pjesërisht si duhet.

Tabela 14. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Realizimi i reformave në mënyrën e duhur

	Realizimi i reformave në mënyrën e duhur				Total
	Po	Pjesërisht	Jo	Nuk e di	

Profili juaj si pjesëmarrës në anketë	Mësues	8	39	33	0	80
	Prind	13	12	9	5	39
	Nxënës	6	4	6	3	19
	Njohës i rrethanave në arsim	4	5	2	0	11
Total		31	60	50	8	149



Profili juaj si pjesëmarrës në anketë


Figura 13..Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Realizimi i reformave në mënyrën e duhur

Se sa janë të kënaqur nga reformat sipas modelit të Kembrixhit,rezulton që vetëm 12 prindër janë plotësisht të kënaqur, 26 pjesërisht ndërsa 39 aspak. Gjithsej 10 prindër janë të kënaqur me këto reforma, 11 prej tyre pjesërisht ndërsa 15 aspak. Tek nxënësit, 7 prej tyre janë të kënaqur, 6 pjesërisht të kënaqur ndërsa 6 aspak të kënaqur nga këto reforma. Po ashtu edhe tek

njohësit e rrethanave në arsim kemi ndarje, ku 3 prej tyre janë të kënaqur, 1 pjesërisht dhe 4 aspak.

Tabela 15. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Kënaqësia nga reformat sipas modelit të Kembrixhit

		Kënaqësia nga reformat sipas modelit të Kembrixhit				Total
		Po	Pjesërisht	Jo	Nuk e di	
Profili juaj si pjesëmarrës në anketë	Mësues	12	26	39	3	80
	Prind	10	11	15	2	38
	Nxënës	7	6	6	0	19
	Njohës i rrethanave në arsim	3	1	4	3	11
Total		32	44	64	8	148



Profili juaj si pjesëmarrës në anketë

Figura 14. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Kënaqësia nga reformat sipas modelit të Kembrixhit

Prej kategorisë mësimdhënës vetëm 10 prej tyre janë të mendimit që modeli Kembrixh ofron arsim kualitativ, 21 se ofron pjesërisht, 44 se nuk ofron. E njëjta situatë është edhe me përgjigjet e dhëna nga prindërit, ku 12 prej tyre janë të mendimit se ofron kualitet, 10 se pjesërisht ofron dhe 12 se nuk ofron aspak. Nxënësit nga ana tjetër mendojnë se ky model ofron cilësi ndërsa njohësit e arsimit janë skeptik në këtë drejtim sikur mësuesit dhe prindërit.

Tabela 16. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Modeli i Kembrixhit a ofron arsim kualitativ						
		Modeli i Kembrixhit a ofron arsim kualitativ				Total
		Po	Pjesërisht	Jo	Nuk e di	
Profili juaj si pjesëmarrës në anketë	Mësues	10	21	44	5	80
	Prind	12	10	12	5	39
	Nxënës	7	4	2	6	19
	Njohës i rrethanave në arsim	3	2	4	2	11
Total		32	37	62	18	149





Figura 15. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Modeli i Kembrixhit a ofron arsim kualitativ

Ndërsa në pyetje se çka ju pëlqen më shumë nga ky model, prindërit ishin më unanim, ku 32 prej tyre u përcaktuan për prezantimin vizual, më pas interaktiviteti. Tek prindërit më e rëndësishme ishte interkativiteti dhe më pas prezantimi vizual. Nxënësit ishin të ndarë në mendime kur njohësit e arsimit ishin më shumë për interaktivitetin nxënës-mësues.

Tabela 17. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Çka ju pëlqen më së shumti në arsimin sipas modelit të Kembrixhit

		Çka ju pëlqen më së shumti në arsimin sipas modelit të Kembrixhit					Total
		Interaktiviteti nxënës-mësimdhënës	Prezantimi vizual	Përsëritja e shpeshtë e mësimëve	Materialet mësimore	Asgjë nga më sipër	
Profili juaj si pjesëmarrës në anketë	Mësues	18	32	10	5	13	78
	Prind	9	8	7	4	11	39
	Nxënës	3	3	3	4	6	19
	Njohës i rrethanave në arsim	4	2	1	0	4	11
Total		34	45	21	13	34	147




Profili juaj si pjesëmarrës në anketë

Figura 16. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Çka ju pëlqen më së shumti në arsimin sipas modelit të Kembrixhit

Pjesa më e madhe e mësuesve, prindërve dhe nxënësve por edhe e njohësve të rrethanave në arsim janë të mendimi se zbatimi gradual i reformave në arsim do të rezultoi me cilësi të plotë ose të pjesërishtme të arsimit, që konkludon se të gjitha palët e përfshira në këtë proces janë të mendimit se reformat duhet të jenë graduale por të vazhdueshme.

Tabela 18. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * A mendoni se zbatimi gradual i reformave do të jep një arsim më kualitativ								
			A mendoni se zbatimi gradual i reformave do të jep një arsim më kualitativ					
			Po	Pjesërisht	Jo	Nuk e di	Total	
Profili juaj si pjesëmarrës në anketë	Mësues		23	29	17	11	80	
	Prind		19	8	9	3	39	
	Nxënës		10	5	3	1	19	
	Njohës i rrethanave në arsim		4	2	3	2	11	
Total			56	44	32	17	149	




Profili juaj si pjesëmarrës në anketë

Figura 17. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * A mendoni se zbatimi gradual i reformave do të jep një arsim më kualitativ

Në të gjithë kategoritë e lartpërmendur theksohet se rritja e rrogave dhe kushteve të punës, do të ndikoj në rritjen e cilësisë së arsimit në përgjithësi, që është një vijë të drejtë me përvojat dhe praktikat ndërkombëtare. Interesant është fakti se gjithsej 42 mësime dhënë, që është më shumë se gjysma e të anketuarve të kësaj kategorie janë të mendimit se rritja e rrogave të mësime dhënë dhe kushteve të punës pjesërisht ose aspak nuk ndikon në rritjen e cilësisë, që është për tu marrë në konsideratë.

Tabela 19. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Sa mendoni se ndikon rroga e mësimdhënësit dhe kushtet e punës në kualitetin e arsimit në përgjithësi

		Sa mendoni se ndikon rroga e mësimdhënësit dhe kushtet e punës në kualitetin e arsimit në përgjithësi			
		Shumë	Pjesërisht	Aspak nuk ndikon	Total
Profili juaj si pjesëmarrës në anketë	Mësues	38	20	22	80
	Prind	24	9	6	39
	Nxënës	13	3	3	19
	Njohës i rrethanave në arsim	6	4	1	11
Total		81	36	32	149




Profili juaj si pjesëmarrës në anketë

Figura 18. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Sa mendoni se ndikon rroga e mësimdhënësit dhe kushtet e punës në kualitetin e arsimit në përgjithësi

Si mësimdhënësit, po ashtu edhe prindërit dhe njohësit e rrethanave mendojnë se pjesërisht ose aspak nuk trajtohen prindërit si duhet nga ana e shoqërisë. Këtë mendim e ndajnë 74 prej mësimdhënësve, 29 prej prindërve, dhe 6 prej ekspertëve.

Tabela 20. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * A mendoni se mësimdhënësit trajtohen në mënyrë të duhur në shoqëri

		A mendoni se mësimdhënësit trajtohen në mënyrë të duhur në shoqëri				Total
		Po	Pjesërisht	Jo	Nuk e di	
Profili juaj si pjesëmarrës në anketë	Mësues	6	38	36	0	80
	Prind	9	19	10	1	39
	Nxënës	9	6	3	1	19
	Njohës i rrethanave në arsim	2	2	4	3	11
Total		26	65	53	5	149




Profili juaj si pjesëmarrës në anketë

Figura 19. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * A mendoni se mësimdhënësit trajtohen në mënyrë të duhur në shoqëri

Në këtë kategori kemi unanimitet të plotë se zgjedhja e drejtorëve nuk bëhet në mënyrë të duhur. Këtë mendim e ndajnë 51 mësues, 18 prindër, 8 nxënës dhe 8 ekspertë ndërsa pjesërisht janë të këtij mendimi 18 mësues, 15 prindër, 2 nxënës dhe 1 ekspert.

Tabela 21. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * A mendoni se përzgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet në mënyrë të duhur								
			A mendoni se përzgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet në mënyrë të duhur				Total	
			Po	Pjesërisht	Jo	Nuk e di		
Profili juaj si pjesëmarrës në anketë	Mësues		5	18	51	6	80	
	Prind		3	15	18	3	39	
	Nxënës		5	2	8	4	19	
	Njohës i rrethanave në arsim		1	1	8	1	11	
Total			14	36	85	14	149	



Profili juaj si pjesëmarrës në anketë


Figura 20. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * A mendoni se përzgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet në mënyrë të duhur

Lidhur me atë se sa është implementuar strategjia e arsimit nga ana e qeverisë, rezultoi që 42 mësues janë të mendimit se pjesërisht është implementuar, ndërsa 20 aspak. Tek prindërit, kemi gjithsej 18 prindër që pjesërisht pajtohen dhe 10 që nuk pajtohen aspak, ndërsa tek nxënësit gjithsej 4 nxënës nuk pajtohen aspak dhe 3 pjesërisht. Tek ekspertët po ashtu vërehet se mendimi i tyre është këto reformat nuk janë realizuar si duhet.

Tabela 22. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Sa mendoni se është implementuar strategjia e arsimit nga ana e qeverisë

	Sa mendoni se është implementuar strategjia e arsimit nga ana e qeverisë	Total

		Plotësisht është implemen tuar	Pjesërisht është implemen tuar	Aspak nuk është implemen tuar	Nuk kam njohuri	
Profili juaj si pjesëmarrës në anketë	Mësues	9	42	20	8	79
	Prind	6	18	10	5	39
	Nxënës	7	3	4	5	19
	Njohës i rrethanave në arsim	2	5	4	0	11
Total		24	68	38	18	148



Profili juaj si pjesëmarrës në anketë

Figura 21.. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë * Sa mendoni se është implementuar strategjia e arsimit nga ana e qeverisë

KONSTATIME DHE REKOMANDIME

Aspirata e vendit për anëtarësim në BE ka gjeneruar shumë vrull për reforma politike, ekonomike dhe sociale. Në këtë drejtim, nxitja e zhvillimit të barabartë dhe gjithëpërfshirës të bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut për të gjithë, në veçanti ndaj nevojave të grupeve më të rrezikuara dhe të marginalizuara, duhet të jenë gjithmonë prioritet. Në ndjekje të kësaj agjende, Qeverisë i duhet një program ambicioz për të mbështetur rritjen ekonomike, për të përmirësuar standardet e jetesës të qytetarëve të saj, të krijojë vende pune, të luftojë korrupsionin, të rrisë mundësitë e arsimit, të zhvillojë demokracinë, të kontribuojë në përmirësimin e marrëdhënieve ndër-etnike dhe të angazhohet në mbrojtjen e mjedisit.

Rruga për në BE jo vetëm që kërkon hartimin dhe miratimin e standardeve dhe ligjeve të BE-së, por gjithashtu do të varet shumë në kapacitetin e vendit për të zbatuar ato. Integrimi Evropian ka sjellë avantazhe të konsiderueshme për qytetarët e saj, por këto avantazhe nuk janë gjithmonë të kuptuara mirë dhe edhe më pak të njohura.

Si organizatat qeveritare ashtu edhe ato joqeveritare luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e formulimit të politikave publike. Aktorët institucional gjatë aktiviteteve të tyre zyrtare participojnë në vendimmarrje në nivele të ndryshme dhe kanë për qëllim që të merren me çështje të tilla si politika e jashtme dhe e brendshme, shëndetësi, arsim, punësim, ekonomi, drejtësi, mjedis, energji, transport, strehim, bujqësi, gjyqësi dhe një mori çështjesh tjera. Varësisht nga pozicioni dhe roli që kanë aktorët institucional dhe joinstitucional në organizatat përkatëse, varet edhe pjesëmarrja e tyre në hartimin dhe zbatimin e politikave në një fushë të caktuar.

Edhe pse autoritetet shpresojnë se procesi i migrimit të rinjve do të ndalet, sërisht, Ministria e Arsimit duhet të marrë masa duke bërë ngritjen e vazhdueshme të cilësisë së arsimit dhe duke e bërë kështu sistemin arsimor në Maqedoni më tërheqës për nxënësit dhe studentët që do të kishin vazhduar arsimimin e tyre.

Reformat në arsim në Republikën e Maqedonisë ende nuk arrijnë të arrijnë rezultatin e dëshiruar. Si rezultat, ne vazhdimisht zvogëlimin e numrit të nxënësve në vitet e fundit, pavarësisht nga fakti se që nga viti 2008 në Maqedoni ka hyrë në fuqi më ligj arsimit të mesëm të detyrueshëm. Nga ana tjetër, ne kemi një numër në rritje të mësimdhënësve që tregojnë një lloj

paradoksi. Strategjia për arsimin në vend duhet të përfshijë analizën e tregut, përcaktimin e nevojës së tregut (mungesa) dhe përgatitjen e strategjisë cilësore arsimit që do të zbatohet do të jetë një funksionimi, me qëllim rritjen e numrit të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme .

Kjo mund të realizohet duke siguruar cilësi të mirë dhe arsimim të duhur (sipas nevojave të tregut të punës) interaktive, duke i dhënë udhëzime për të trajnuar nxënësit që të jetë kompetent në tregun e punës. Kjo duhet të bëhet me staf cilësor që do të përgatitet me trajnim të vazhdueshëm.

Rëndësia e përcaktimit të nevojave të tregut të punës, ku të diplomuarit do të kenë mundësinë për punësim pas përfundimit të arsimit të tyre dhe të motivuar prindërit dhe nxënësit për t'u arsimuar në vendin e tyre.

Përmirësimi i mundësive të punësimit pas diplomimit, duke siguruar udhëzime të duhura, duke rritur cilësinë e arsimit do të ndikojë drejtpërdrejt në uljen e migrimit të të rinjve. Duke reduktuar migrimin e të rinjve nuk do të ketë reduktim të numrit të studentëve, por do të ketë një rritje në numrin e studentëve.

BIBLIOGRAFIA

- Abdullai, J. 2016. Politika dhe politikat publike, Arbëria Design, Tetovë
- Abdurrahmani, T. 2013. The Teacher Qualification Scheme: A Case of Albania. Problems of Education in the 21st Century, Vol. 55
- ACCE (Albanian Coalition for Child Education). 2013. Albania: The Situation of Pre-University Education. Tirana.
- Caena, F. 2011. Literature review: Quality in Teachers' continuing professional development. European Commission, Education and Training Working Group 2020.
- Coolahan, J. 2002. Teacher Education and the Teaching Career in an Era of Lifelong Learning. OECD Education Working Papers, No. 2, OECD Publishing.
- Harizaj, A. 2011. A case study of Albania's participation in PISA 2009. CEPS Journal, Vol. 1 No. 3, pp. 97-118.
- Haxhihyseni, S. 2014. Changes in the School Curriculum in Albania. Journal of Educational and Social Research
- IED (Institute for Educational Development). 2015. Country Background Report
- Strategy on Pre-University Education Development 2014-2020. Tirana
- Rukaj, M. 2012. Albania: The Boom of Private Schools. Osservatorio Balcani e Caucaso
- Smith, I. and Hamilton, T. 2011. Risk Analysis of the Albanian Education System (Incorporating Analysis of the System for the Recruitment, Appointment and Promotion of Education Teaching Staff in the Compulsory Education System. Council of Europe, 2013, Underpinning Integrity in the Albanian Education System: Compilation of PACA Outputs.
- Vula, E., Saqipi, B. Karaj, T. and Mita, N. 2012. Moving towards Practice-Oriented and ResearchBased Teacher Education. Excellence in Higher Education, Vol. 3, No. 1
- Enti Shteteror i Statistikes, Migrimet
2016.http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija_en.aspx?id=9
- UNICEF, Migration Profiles: The Former Yugoslav Republic of Macedonia
- Strategjia e Arsimit në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2018-2015, f.14
- Burimi: Projekti i USAID-it për integrimin ndëretnik në arsim.

- Jonuz Abdullai, Politika dhe politikat publike, Arberia Design, Tetovë
- <https://faktor.mk/reformi-vo-obrazovaniето-site-nezadovolni-ama-vazhno-da-se-turka/>
- <https://nezavisen.mk/mk/vesti/2018/01/17754/>
- <http://mon.gov.mk/index.php/AL/2014-07-23-14-03-25/vesti-i-nastani-alb/434-paket-reformi-al>
- Strategjia e arsimit për periudhën 2018-2025, f.8
- Nora Dudwick & Helen Shahriari, Arsimi në Shqipëri: Qëndrime dhe shpresa në ndryshim, Stevla Tiranë, 2000, f.9
- Nikolin Germenji, Decentralizimi dhe Dekoncentrimi i Kompetencave, Emërimet e Mësuesve dhe Drejtuesve të Shkollave, Këndvështrimi i Nxënësit, Pjesmarrja e Prindërve në Arsim, Problemet e Shkolles, Qeverisja e Shkollës, Sigurimi i Cilësisë dhe Vlerësimi i Performancës
- <http://www.arsimi.al/arsimi-ne-kendveshtrimin-e-reformave/>
- TONIN GJURAJ, Arsimi i lartë në Shqipëri, e kaluara dhe e tashmja, Panorama, 2012
<http://www.panorama.com.al/arsimi-i-larte-ne-shqiperi-e-kaluara-dhe-e-tashmja/>
- UNESCO, Seksioni i Politikës Arsimore, Shqipëria, Analiza e Politikës Arsimore: Çështje dhe Rekomandime
- Raporti i zgjeruar, Paris 2017, f.3
- <http://www.arsimi.al/arsimi-ne-kendveshtrimin-e-reformave/>
- Juljana Laze, SFIDAT E SISTEMIT TË LARTË ARSIMOR NË SHQIPËRI DREJT ZONËS EUROPIANE, Tiranë, 2015
- Strategjia e Zhvillimit të Arsimit të Republikës së Shqipërisë 2014-2020
- UNESCO, Seksioni i Politikës Arsimore, Shqipëria, Analiza e Politikës Arsimore: Çështje dhe Rekomandime
- Raporti i zgjeruar, Paris 2017, f.177
- Jonuz Abdullai, Ndryshimet sociale dhe tranzicion, CRPA & Arberia Design, Tetovë 2008, f.17
- Dashmir Idrizi, Sfidat e arsimit sipëror në gjuhën shqipe në RM, Tetovë 2013, f.60

SHTOJCA

Pyetësi

I/e nderuar,

Me këtë pyetësor kam për qëllim të bëj një vështrim më të specializuar (hulumtim shkencor) në lidhje me reformat e sistemit arsimor në Maqedoni për periudhën kohore 2008-2016, prandaj duke ju garantuar anonimitet të plotë, më duhet ndihma e juaj në plotësimin e këtij pyetësi! Të dhënat e juaja do të jenë anonime dhe të njëjtat do të shfrytëzohen për hulumtimin shkencor në sajë të magistraturës time.

1. Sa jeni të kënaqur me reformat e realizuara nga ana e qeverisë në fushën e arsimit në Maqedoni në 10 vitet e fundit?

- a) Shumë i kënaqur
- b) Pjesërisht i kënaqur
- c) Pak i kënaqur
- d) Aspak

2. A mendoni se reformat në arsim janë realizuar në mënyrë të duhur, duke siguruar trajnime paraprake dhe pajisje të mirëfilltë me materiale?

- a) Po
- b) Pjesërisht
- c) Jo
- d) Nuk e di

3. A jeni të kënaqur me reformat në arsim sipas modelit të Kembrixhit?

- a) Po
- b) Pjesërisht
- c) Jo
- d) Nuk e di

4. A mendoni se modeli i Kembrixhit ofron arsimim më kualitativ?

- a) Po
- b) Pjesërisht
- c) Jo
- d) Nuk e di

5. Çka ju pëlqen më së shumti në arsimin sipas modelit të Kembrixhit?

- a) Interaktiviteti nxënës - mësimeve
- b) Prezantimi vizual
- c) Përsëritja e shpeshtë e mësimeve?
- d) Materialet mësimore
- e) Asgjë nga më sipër

6. A mendoni se zbatimi gradual i reformave do të jep një arsim më kualitativ?

- a) Po
- b) Pjesërisht
- c) Jo
- d) Nuk e di

7. Sa mendoni se ndikon rroga e mësimeve dhe kushtet e punës në kualitetin e arsimit në përgjithësi?

- a) Shumë
- b) Pjesërisht
- c) Aspak nuk ndikon

8. A mendoni se mësimeve trajtohen në mënyrë të duhur në shoqëri?

- a) Po
- b) Pjesërisht
- c) Jo
- d) Nuk e di

9. A mendoni se përzgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet në mënyrë të duhur?

- a) Po
- b) Pjesërisht
- c) Jo
- d) Nuk e di

10. Sa mendoni se është implementuar strategjia e arsimit nga ana e qeverisë?

- a) Plotësisht është implementuar
- b) Pjesërisht është implementuar
- c) Aspak nuk është implementuar
- d) Nuk kam njohuri

11. Profili juaj si pjesëmarrës në anketë:

- a) Mësues
- b) Prind
- c) Nxënës
- d) Njohës i rrethanave në arsim

Ju faleminderit.

Прашалник

Почитувани,

Со овој прашалник имам намера да направам по специфичен преглед (научно истражување) за реформите во образовниот систем во Македонија за периодот 2008-2016 година, затоа и ја барам вашата помош при пополнување на овој прашалник. Вашите податоци ќе се користат исклучиво за научно истражување во склоп на мојата магистерска теза.

1. Колку сте задоволни од реформите што ги спроведува македонската влада во областа на образованието во Македонија во последните 10 години?

- a) Многу задоволен
- b) Делумно задоволен
- c) Малку задоволен
- d) Воопшто не сум задоволен

2. Дали сметате дека реформите во образованието се правилно спроведени, со претходно обезбедена обука и соодветна материјална опрема?

- a) Да
- b) делумно
- c) Не
- d) Не знам

3. Дали сте задоволни од реформите во образованието според моделот Кембриџ?

- a) Да
- b) делумно
- c) Не
- d) Не знам

4. Дали мислите дека моделот Кембриџ нуди поквалитетно образование?

- a) Да
- b) делумно

- c) Не
- d) Не знам

5. Што најмногу ви се допаѓа во образованието според моделот Кембриџ?

- a) Интеракцијата меѓу учениците и наставниците
- b) Визуелната презентација
- c) Честото повторување на наставата?
- d) Наставните материјали
- e) Ништо од горенаведеното

6. Дали мислите дека постепеното спроведување на реформите ќе обезбеди поквалитетно образование?

- a) Да
- b) делумно
- c) Не
- d) Не знам

7. Колку, според вас, влијае платата на наставникот и условите за работа врз квалитетот на образованието воопшто?

- a) Многу
- b) делумно
- c) Воопшто не влијае

8. Дали мислите дека наставниците соодветно се третираат во општеството?

- a) Да
- b) делумно
- c) Не
- d) Не знам

9. Дали мислите дека изборот на директори на училишта е правилно направен?

- a) Да
- b) делумно
- c) Не
- d) Не знам

10. Колку е имплементирана образовната стратегија на владата?

- a) целосно имплементирана
- б) Делумно имплементирана
- в) Воопшто не се спроведува
- г) Немам сознанија

11. Вашиот профил како учесник во истражувањето:

- a) Наставник
- b) Родител
- c) Ученик
- d) Познавач на околностите во образованието

Ви благодарам.